



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

Raport i Kolegjit Universitar "Beder"
Qershor 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|----------------------|---------|
| 1 | Prof. Edward J Esche | Kryetar |
| 2 | Prof. Andy Cobb | Anëtar |
| 3 | Prof. Juliana Latifi | Anëtare |

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raporti i detajuar.....	7
Evaluation Area 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	7
Evaluation Area 2: Burimet.....	11
Evaluation Area 3: Kurrikula.....	15
Evaluation Area 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	18
Evaluation Area 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre.....	23
Lista e dokumenteve.....	27

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, i cili përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'i ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe formave me të cilat mbështetet mësimnxënia e studentëve).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm iu referua Manualit të APAAL-it për vitin 2016-2017, Raportit të Vetëvlerësimit, një sërë dokumentesh që shërbenin si bazë faktesh, dokumenteve të kërkuara shtesë dhe mbledhjeve të organizuara me punonjës të niveleve të ndryshme, studentë dhe palë interesi.

Në fund, ekspertët do ta përmyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka ofruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Universitar Beder (KUB) u hap në prill të vitit 2011 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si institucion i arsimit të lartë, në vijim të kërkesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. KUB-ja është një institucion në fushën e arsimit të lartë, që funksionon si një organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i institucionit dhe i gjithë programeve të tij të studimit pasqyron cilësinë dhe standardet e KUB-së. Kolegji ofron programe studimi në fushën e shkencave humane dhe sociale, duke synuar të sjellë një profil të veçantë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Synimi i KUB-së është ofrimi i cilësisë akademike dhe institucionale, e cila përcakton vizionin e funksionimit të institucionit, për një numër studentësh nga 1250 deri në 1500, të regjistruar në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, si Bachelor ashtu edhe Master. Synim i KUB-së është krijimi dhe konsolidimi i një profili ndërkombëtar. Gjatë gjashtë viteve të ushtrimit të veprimtarisë së tij, institucioni ka pranuar studentë nga territoret shqipfolëse të rajonit dhe diasporës, si dhe nga vendet evropiane dhe më gjerë. Prurjet e studentëve të rinj nga vende të ndryshme janë rritur ndjeshëm gjatë këtyre gjashtë viteve dhe tani ai ka studentë që vijnë nga 16 vende të ndryshme. Përveç kësaj, përbërja e stafit akademik pasqyron aspiratat ndërkombëtare të institucionit, i cili përforcohet vazhdimisht nëpërmjet bashkëpunimeve të reja dhe atyre ekzistuese të lidhura me universitete dhe shoqëri tjera në shumë vende. Gjatë gjashtë viteve të ushtrimit të veprimtarisë së tij, 621 studentë kanë përfituar nga ulja e tarifave të studimit. KUB-ja ka organizuar një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare, seminaresh të hapura dhe workshop-e, të cilat kontribuojnë në kërkimin shkencor dhe në shoqëri.

Raport i përmbledhur

KUB-ja është një institucion jofitimprurës me seli në Tiranë. Kolegji ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në gjuhën shqipe, turke dhe atë angleze. Universiteti përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, dhe Fakulteti i Shkencave Humane. Misioni i tij është përgatitja e individëve të kualifikuar duke zbatuar një filozofi arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Këtë e realizon nëpërmjet gjashtë departamenteve dhe dy qendrave kërkimore në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Gjuhës dhe Letërsisë Turke, Shkencave të Edukimit, Drejtësisë, Shkencave të Komunikimit dhe Shkencave Islame. Në vitin akademik 2016-2017, KUB-ja kishte 745 studentë të regjistruar në programet e studimit me kohë të plotë.

Një grup nga universiteti përpiloi Raportin e Vetëvlerësimit (RVV). Ky grup, i përbërë prej gjashtë vetash, përfshinte drejtues të lartë, personel akademik dhe mbështetës, dhe një përfaqësues të studentëve. Versioni zyrtar u qarkullua dhe u plotësua nga të gjitha nivelet përbërëse të kolegjit. Më vonë, pas marrjes së përgjigjeve, çdo anëtar iu caktua fusha specifike për të cilën do të ishte përgjegjës. Ata identifikuan boshllëqet, dhe më pas, sipas rastit, kërkuan informacione shtesë. Përfaqësuesi i studentëve u përfshi në të gjithë procesin. Përgjegjësit e departamenteve diskutuan me stafin dhe studentët e tyre rreth projektraportit. Raporti përfundimtar iu dërgua Rektorit për miratim. Cilësia e Raportit të Vetëvlerësimit ishte e pranueshme, por kishte disa problematika të vogla. Në disa raste, mënyra e të shprehurit në anglisht ishte i vështirë për t'u kuptuar dhe në disa raste të tjera, pohimet nuk kishin referencë të plotë. Megjithatë, KUB-ja, sa herë që iu kërkua, i dorëzoi brenda afateve dokumente shtesë, të cilat e ndihmuan Grupin e Vlerësimit të Jashtëm në punën e tij.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, në datat 12 dhe 13 qershor 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë me përvojë në arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e personelit të institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumente shtesë para dhe gjatë vizitës. Gjithsej u morën në konsideratë 176 dokumente, të cilat e ndihmuan Grupin e Vlerësimit të Jashtëm të njihej me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga KUB-ja. Këto dokumente përfshinin Statutin e KUB-së, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listat e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe atë administrativ, partnerët e jashtëm, punëdhënësit dhe alumnit. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve të ndryshme. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime, si nga pjesëmarrësit shqiptar, ashtu edhe nga ata anglezë. Si pjesë e vizitës në kampusin kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, ambientet sociale dhe zyrat, dhe pati mundësinë të shihte një ilustrim të sistemit elektronik të informacionit dhe atij online të universitetit. KUB-ja ofroi shërbimin e përkthimit gjatë të gjitha mbledhjeve.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht. Një standard, **Kapitulli III Standardi III.4**, nuk është përmbushur plotësisht, por kjo nuk përbën rrezik serioz për drejtimin e kësaj fushe. KUB-ja funksionon në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj, dhe i përmirëson ato rregullisht. Kolegji menaxhohet me efikasitet nëpërmjet organeve drejtuese, si Bordi Administrativ, Senati Akademik dhe këshillat e fakulteteve, të cilat stafi merr pjesë dhe zhvillon debate të dobishme për vendimmarrjen. KUB-ja ka hartuar një strategji zhvillimi. Kolegji është i vetëdijshëm për përgjegjësitë që ka kundrejt sigurimit të cilësisë, dhe për këtë arsye ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe një Komision të ri të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Institucioni përgatit një raport të detajuar mbi monitorimin vjetor, të cilin e vënë dispozicion të stafit dhe studentëve, dhe e dorëzoi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. KUB-ja është e mirëorganizuar dhe ka strukturat e duhura për përmbushjen e

misionit të saj në ofrimin e arsimit cilësor për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, nëpërmjet gjashtë departamenteve në dy fakultete. KUB-ja bashkëpunon me partnerë në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, në dobi të stafit dhe studentëve. KUB-ja frekuentohet edhe nga studentë dhe staf ndërkombëtar. Mungesa e një politike të shkruar për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj identifikohet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që KUB-ja, në të ardhmen e afërt, t'i kushtojë më shumë vëmendje hartimit dhe zbatimit të një politike për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj.

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi dobësi dhe nuk dha rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi. KUB-ja i menaxhon mirë burimet e saj njerëzore. Stafi punësohet në mënyrë transparente, duke ndjekur një politikë të hapur njoftimesh për vendet e lira. Në fillim të çdo viti, kolegji prezanton personelin administrativ dhe shkencor, i cili merr informacion për përgjegjësitë që ka. Vlerësimi i stafit akademik kryhet duke respektuar një rregullore të posaçme. KUB-ja menaxhon në mënyrë efektive situatën financiare duke përgatitur buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj dhe të përshtatura me hierarkinë e saj të brendshme, që ndjek linjën nga poshtë-lartë. Më pas, ky buxhet shpërndahet nga Këshilli i Lartë. KUB-ja ka një sistem të mirë të menaxhimit të informacionit, Sistemin e Informacionit Beder (SIB), nëpërmjet së cilit menaxhohen në mënyrë efektive veprimet e institucionit. Kolegji menaxhon mirë pasuritë e paluajtshme të tij dhe ruan arkivin në përputhje me Rregulloren e tij të Brendshme. KUB-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për kryerjen e veprimtarisë së saj. I gjithë dokumentacioni i veprimtarisë akademike ruhet në format elektronik dhe të shtypur.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi dobësi dhe nuk dha rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi. Padyshim, programet e studimit që ofron KUB-ja janë në përputhje me misionin dhe kapacitetet e saj, por ajo nuk ofron mundësi për formimin e vazhdueshëm. Programet e studimit ofrohen qartazi në përputhje me strategjinë e zhvillimit sipas prirjeve vendore, kombëtare (veçanërisht në drejtësi) dhe ndërkombëtare (në veçanti, prirjet turke). Programet përkufizohen dhe ofrohen qartazi në kuadër të kapaciteteve fizike dhe njerëzore që ka institucioni. Programet e ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë. Këto programe janë hartuar t'i ndihmojnë studentët të familjarizohen me institucionin, madje është vetë stafi i KUB-së, përfshirë këtu edhe Dekanin e Studentëve, që i ndihmon studentët gjatë kësaj faze. Programet e ciklit të dytë mbështeten te stafi aktiv në punë kërkimore, si dhe në prurjet e partnerëve të bashkëpunimit. KUB-ja mban të dhëna statistikore për studentët e diplomuar, dhe sipas tyre rreth 87 për qind e studentëve të diplomuar janë të punësuar. Programet e studimit janë formuluar sipas procesit të Bolonjës për ofrimin e mundësive të mobilitetit të studentëve në Evropë. Programet e studimit të KUB-së ndërthurin punën praktike me atë teorike, gjë që i përgatit studentët për tregun e punës.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Njëri prej standardeve, **Kapitulli II Standardi I.8**, nuk është përmbushur plotësisht, por kjo nuk përbën rrezik serioz për drejtimin e kësaj fushe. Të gjithë elementët e programeve të studimit organizohen dhe zbatohen në mënyrë efektive, përfshirë ato që kanë të bëjnë me praktikën profesionale dhe stazhin. KUB-ja i pajis me diplomë të gjithë studentët, që i përmbushin me sukses këto kërkesa. KUB-ja, nën mbikëqyrjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe një Komisioni të ri të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit, siguron përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha programeve të studimit. Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e mësimdhënies, me anë të vlerësimit të stafit dhe programeve formuese. KUB-ja vë në dukje dhe mbështet kërkimin shkencor nëpërmjet departamenteve dhe qendrave të kërkimit shkencor. Suksesi i arritur në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin, ndonëse i kufizuar, është i përshtatshëm për një institucion që nuk ofron programe studimi të ciklit të tretë. Në Planin e tij Strategjik, Kolegji parashtron prioritetet e kërkimit shkencor, por ato janë të përgjithshme dhe nuk përmbajnë objektiva specifike. Megjithatë, ato vihen në zbatim nga departamentet dhe qendrat kërkimore të cilat sigurojnë vazhdimësinë e kërkimit. KUB-ja boton rezultatet e kërkimit shkencor, por nuk bën vlerësimin e duhur të tyre. Aktualisht, mekanizmat bazë të vlerësimit nuk janë funksionale për konferencat shkencore, grantet dhe projektet e kërkimit, gjë që identifikohet si dobësi. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që KUB-ja t'i kushtojë vëmendje të menjëhershme marrjes së masave për përmirësimin e kërkimit shkencor, duke zbatuar tërësisht udhëzuesin për përgatitjen e konferencave shkencore, dhe Komisionin e Ri të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. KUB-ja ndjek politikën e duhur për pranimin e studentëve të rinj. Ajo e informon dhe komunikon me stafin dhe studentët në mënyrë efikase, nëpërmjet mbledhjeve ballë për ballë, emaileve, mjeteve sociale dhe faqes së internetit. Ajo ka struktura të përshtatshme për mentorimin dhe orientimin e studentëve gjatë programeve të studimit, si shërbimet mbështetëse dhe këshilltarët individualë akademikë. Për përmbushjen e nevojave të studentëve, institucioni ofron literaturën bazë në format elektronik dhe të shtypur, dhe Guidën e Studentëve, i cili siguron që studentët të kenë informacion të hollësishëm dhe lehtësisht të arritshme në një material të vetëm rreth programeve të tyre të studimit dhe të gjitha aspektet e tjera të jetës studentore në universitet. Këto konsiderohen si karakteristika të praktikës së mirë. Institucioni i përkrah studentët nga kategori të ndryshme sociale, përfshirë ata me aftësi të kufizuara. KUB-ja nxit pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale nëpërmjet Këshillit Studentor dhe përfaqësuesit të studentëve në organet e tij drejtuese. Cilësia e jetës studentore për sa i takon aktivitetet kulturore dhe sportive nuk është në nivel shumë të lartë. Institucioni mbështet fuqishëm njohjen e studentëve me tregun e punës nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit me institucionet vendore.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në tre fusha dhe kryesisht në dy të tjera.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Guida e studentëve të KUB-së, i cili iu siguron studentëve informacione të hollësishme dhe lehtësisht të arritshme në një material të vetëm rreth programeve të tyre të studimit dhe të gjitha aspekteve të tjera të jetës studentore në universitet (pika 5.3; **Kapitulli I Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një politike të shkruar për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- mekanizmat bazë të vlerësimit nuk janë funksionalë për konferencat shkencore, grantet dhe projektet e kërkimit (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- kushtimi i vëmendjes nga ana e KUB-së, në të ardhmen e afërt, hartimit dhe zbatimit të një politike për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- përqendrimi menjëherë i KUB-së në marrjen e së masave për përmirësimin e vlerësimit të kërkimit shkencor, duke zbatuar tërësisht udhëzuesin përkatës për përgatitjen e konferencave shkencore dhe Komisionin e Ri të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Përmbledhje e gjyqimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Kolegjin Universitar “Beder”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 KUB-ja u themelua në vitin 2011 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6 prill 2011, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si Institucion i Arsimit të Lartë, në vijim të kërkesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. **[RVV fq.9; 4]** KUB-ja funksionon si një fondacion me tre burime kryesore të ardhurash, që janë: tarifat e studimit, donacionet nga sponsorët dhe fondet publike për një ndërtesë të re. Kolegji është një institucion jofitimprurës i arsimit të lartë, sipas nenit 107 të Statutit të tij. **[2]** KUB-ja i përmbahet dispozitave të ligjit nr. 80/2015, datë 22 korrik 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. KUB-ja zotohet të përmirësojë rregulloret, udhëzuesit dhe statutet e saj në përputhje me diskutimet që zhvillohen në Qeverinë Studentore dhe Senatit Akademik. **[18][Kapitulli III Standardi 1.1]**
- 1.2 Misioni i KUB-së është përgatitja e individëve të kualifikuar me anë të edukimit që përfshin vlera universale dhe mbështetja e kërkimit shkencor, zbatimit të ideve dhe projekteve në shërbim të shoqërisë. **[B4, fq.2]** Sipas statutit të KUB-së, organet e brendshme drejtuese janë Senati Akademik, Bordi Drejtues, Rektorati, dekanët e fakulteteve, Këshilli i Etikës dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[2; 8]** Autoritetet drejtuese janë Rektori, dekanët, përgjegjësit e departamenteve, përgjegjësit e qendrave kërkimore dhe Administratori i Kolegjit Universitar. **[4; 5]** Dy fakultete të përbërë nga gjashtë departamente akademike ofrojnë shtatë programe studimi Bachelor, shtatë Master të Shkencave dhe dy Master Profesional, në shkenca humane dhe shkenca sociale. **[RVV fq.9; 4][Kapitulli III Standardi 1.2]**
- 1.3 Axhendat dhe dokumentacioni i mbledhjeve shpërndahen dy ditë para zhvillimit të takimeve të Këshillit. Kjo është kohëzgjatja minimale ligjore për njoftim, dhe zakonisht konsiderohet si afat i mjaftueshëm për njoftimin paraprak për t'u përgatitur. Nëse Senati Akademik vendos që nevojitet më shumë kohë, atëherë axhendat dhe dokumentet vihen në dispozicion më përpara. **[M3; M4]** Mbledhjet kryhen sipas Statutit dhe rregulloreve përkatëse. **[RVV fq.12; 4]**. Senati Akademik mbledhet të paktën një herë në muaj dhe Rektori organizon mbledhje të tjera shtesë sipas nevojave. **[2, neni 13]** Të gjitha vendimet e Këshillit Administrativ dhe të Administratorëve **[M13]** publikohen në format elektronik online si edhe në format të shtypur. Versioni i shtypur, nëse është i nënshkruar, përdoret si një dokument zyrtar. Senati dhe këshillat kanë kompetenca vendimmarrëse dhe propozuese **[RVV fq.13; 4]**, ndërsa Kancelari Akademik monitoron zbatimin e vendimeve. **[M3; M4]** Kancelari është kreu i administratës dhe i raporton Rektorit. **[5, neni 25]** Vendimet e këshillit të departamentit protokollohen, regjistrohen dhe nënshkruhen nga palët që i marrin ato në dorëzim. Më pas, ato skanohen dhe qarkullohen tek i gjithë stafi dhe studentët me email. Përfundimet bëjnë pjesë të përmbajtjes së Raportit Vjetor. **[M10]** Rezultatet e ofertave vjetore nga departamentet për burime përcillen pranë këshillave të departamentit dhe janë tërësisht transparente. **[M10] [Kapitulli III Standard 1.3]**
- 1.4 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e KUB-së është përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të menaxhimit, vlerësimit administrativ dhe akademik të përmirësimit të cilësisë dhe vlerësimit të jashtëm. **[RVV fq.13; 4]** Gjithashtu, kjo zyrë bashkëpunon me Departamentin e Burimeve Njerëzore për formimin e stafit. **[M2]** Njësia ka marrë përsipër detyrimet dhe i përmbahet dispozitat që rrjedhin nga Procesi i Bolonjës. **[9; 21]** Për më tepër, institucioni ka ngritur dy komisione të tjera shtesë të përhershme, për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion, dhe për Sigurinë e Cilësisë së Standardeve Ndërkombëtare dhe Programeve të Studimit përkatësisht. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet veprojnë në mënyrë të pavarur, dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë qartësisht të përcaktuara. **[9; 21; Shpjegime 2]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për çështje operationale, si monitorimi dhe raportimi, ndërsa Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është përgjegjës për çështje strategjike, si koordinimi i procesit të sigurimit të cilësisë. Ai përgatit strategjitë, objektivat, politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin e cilësisë. **[M2; M3; M4]** Në vitin 2014, një eksperte e jashtëm u caktua nga Senati për Njësinë dhe Komisionin për Sigurimin e Cilësisë **[37]** që të kryejë një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha veprimtarive akademike dhe administrative. Secila njësi dorëzoi një raport vetëvlerësimi dhe për të ekspertja e jashtëm dha mendimin e saj, **[A56]** i cili më pas u përfshi në Raportin

Vjetor 2015-2016. **[B4]** Ekspertja vizitoi gjashtë herë ambientet e KUB-në, mori pjesë në mbledhje të secilës njësi dhe bëri një vlerësim të jashtëm për të gjitha çështjet e diskutuara. Përveç komenteve specifike për secilin program, ajo sugjeroi fushat e përbashkëta ose përmirësime, siç është: nevoja për ndërmarrjen e kërkime më të hollësishme dhe specifike të tregut, konsistenca e informacionit të paraqitur në syllabuse dhe faqet e internetit, marrja e më shumë informacioneve nga anketimet e studentëve, dhe shumëllojshmëria në programet, titujt dhe përmbajtje. **[M3; M4]** **[Kapitulli III Standard I.4]**

- 1.5 Në vitin 2012, KUB-ja miratoi një plan strategjik pesëvjeçar, duke shënuar si sfidë kryesore ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike të institucionit. Ai synonte zhvillimin e kërkimit, mësimdhënies dhe kontributit social. Objektiva të tjera përfshinin: krijimin i një axhende ndërkombëtare në fushat e kërkimit disiplinor dhe ndërdisiplinor, ofrimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies në programet e ciklit të parë dhe të dytë, dhe tërheqjen, formimin dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar në arenën ndërkombëtare. Strategjia është rishikuar dhe ndryshuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[RVV fq.15; 4; 35]**. Është ngritur një grup pune, kryesuar nga Rektori, për të përgatitur një plan të ri strategjik për periudhën 2017-2022. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të Rektoratit, departamenteve, njësive qendrore, Senatit Studentor dhe studentëve të diplomuar. **[RVV fq.15; 4; 46]**. Grupeve janë ngarkuar me detyrim të zbatimit të një proces nga poshtë-lartë. Plani i ri parashikohet të përfundojë në shtator të vitit 2017. **[M1; M6]** Pas miratimit të Planit Strategjik 2017-2022, do të përgatitet një plan veprimi për kërkimin shkencor. **[M13]** **[Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.6 Rektori lëshoi udhëzim drejtuar të gjitha njësive administrative dhe akademike për përgatitjen një plan kombëtar për vitin 2015-2016. **[71; 58]** Ai mbështetet në një format të caktuar nga Ministra e Arsimit dhe Sportit, por për të nuk nevojitet një plan veprimi. **[B4]** Përfundimet e mbledhjeve të departamentit, të cilat marrin pjesë dhe studentët, përfshihen te Raporti Vjetor, ndërkohë që për çdo projekt departamentet konsultohen me studentët. **[M10]** Kancelari akademik monitoron përfundimet e raporteve të mëparshme dhe punon me departamentet, për të garantuar që ato zbatojnë vendimet e Senatit. **[M3; M4]** Raporti pasqyron veprimtarinë e brendshme dhe të jashtme të KUB-së, i cili iu shpërndahet një audience të gjerë. **[Kapitulli III Standard I.6]**
- 1.7 KUB-ja mbështet autonominë dhe lirinë akademike si elementë kryesorë të misionit dhe objektivave të tij, siç përcaktohet edhe në Statut. **[RVV fq. 16; 1 Neni 6; 2 Neni 2, dhe 87; 4]** Më parë, Senati Akademik i kushtonte më shumë vëmendje çështjeve akademike. Ndërsa tashmë miraton buxhetet akademike dhe ia propozon ato Këshillit të Lartë, i cili së shpejti do të themelohet si Këshill i Administrimit, lidhur me rezultatet përfundimtare. **[M3; M4]** Organi më i lartë vendimmarrës është Këshilli i Lartë, i cili drejtohet nga njëri prej themeluesve. Kancelari, i cili është dhe Zyrtari më i Lartë Administrativ, është anëtar i Këshillit të Lartë dhe Senatit Akademik. Këshilli i Lartë ka shtatë anëtarë, katër janë themeluesit nga komuniteti mysliman dhe tre janë të përzgjedhurit nga anëtarët e Senatit Akademik. **[M13]** Këshillat e fakulteteve dhe këshillat e departamenteve janë organet e çdo fakulteti. Rolet e tyre përcaktohen me hollësi në Statut, në Rregulloren për Organizimin Akademik dhe në Rregulloren për Organizimin Administrativ, në të cilat parashtrohen edhe proceset e vendimmarrjes. **[RVV fq.17; 2; 3; 4; 5]** **[Kapitulli III Standard II.1]**
- 1.8 KUB-ja respekton pjesëmarrjen në debate. Këshillat propozojnë, rekomandojnë dhe marrin vendime, të cilat i komunikojnë me shkrim ose nëpërmjet emailit. **[RVV fq.17; 4]** Stafit i nxitet të marrë pjesë dhe të kontribuojë në çdo çështje që lidhet me njësinë përkatëse. Çështjet e ngritura shpesh diskutohen në mbledhje të nivelit më të lartë, konkretisht në këshillat e fakultetit ose në Senatit Akademik. **[B5]** Raportet për veprimtarinë dhe planet vjetore, duke përfshirë analizën lidhur me pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet, shërbejnë si bazë për planet e ardhshme. **[72]** Stafit i nxitet të paraqesë dhe të diskutojë problemet e ndeshura, si edhe të propozojë zgjidhje. **[Kapitulli III Standard II.3]**
- 1.9 Zyra e Medias monitoron zhvillimet ekonomike të rajonit në gazeta dhe revista për informimin e Rektoratit në lidhje me planifikimin e tij strategjik. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun monitoron raportimin e arsimit të lartë për zyrën e Rektorit. Zyra e Karrierës në secilin departament akademik vlerëson punësimin e të diplomuarve të tij. Zyra Qendrore e të Diplomuarve dhe e Planifikimit të Karrierës monitoron punësimin e të diplomuarve. Në tre vitet e fundit, 78% e

studentëve të diplomuar në Bachelor dhe 88% e të diplomuarve në Master janë punësuar ose ndjekin studime më të larta. **[RVV fq.18; 84]** Megjithëse nuk ka evidenca për strategjinë specifike të marketingut, KUB-ja e mbështet zhvillimin e programeve të reja të studimit e tregut. **[M3; M4]** Megjithatë, një ekspert i jashtëm nxori në pah nevojën për studime më specifike dhe më të hollësishme të tregut si një fushë për t'u përmirësuar. **[56]** KUB-ja bashkëpunon me shoqëri publike dhe private, dhe ofron mundësi për bashkëpunim me organizata konkurrense. **[54]** Mbledhja me Alumni, punëdhënës dhe partnerë të jashtëm nxori në pah bashkëpunimin e ngushtë me komunitetin mysliman të Shqipërisë dhe të rajonit për përmbushjen e qëllimeve të KUB-së, veçanërisht lidhur me stazhet e administruara nga Zyra e Karrierës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se stazhi shpesh ka rezultuar si hapi i parë drejt punësimit në fushat e gazetarisë, psikologjisë, teologjisë, burimeve njerëzore, mësimdhënies dhe të drejtës penale. Bordi i të Diplomuarve shërben për takimin midis Alumini, ndërsa, çdo vit, KUB-ja analizon zhvillimin e karrierës. **[M7][Kapitulli III, Standard III.1]**

- 1.10 KUB-ja bashkëpunon me institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me 56 institucione të arsimit të lartë, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj, duke përfshirë 14 në Turqi dhe 24 në 15 vende të tjera. **[RVV fq.19; 92; 4]** Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare u krijua në vitin 2011 në përputhje me rregulloret **[5, Nenet 21 dhe 22]**, dhe Drejtori i Zyrës i raporton Rektorit. **[5, Neni 22]**. Ajo iu ka mundësuar një numri të madh pedagogësh dhe studentësh të fitojnë përvojë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim. Ajo organizon gjithashtu shkëmbime studentore dhe nxit mobilitetin e stafit dhe studentëve. **[66] [Kapitulli III Standard III.2; Kapitulli III Standard III.3]**
- 1.11 Gjatë pesë viteve të fundit, KUB-ja ka organizuar 26 konferenca ndërkombëtare në bashkëpunim me organizata brenda dhe jashtë Shqipërisë. Stafi akademik ka marrë pjesë në veprimtari jashtë vendit. **[B7; C2]** 25% e studentëve të KUB-së vijnë nga 16 shtete të huaja. Janë punësuar gjithashtu pedagogë nga jashtë vendit. **[RVV fq.19; 66]** Integrimi i studentëve dhe pedagogëve të rinj është përcaktuar në Guidën e Studentëve dhe Guidën e Stafit, por ato japin informacione të kufizuara për stafin e huaj, dhe aspak informacion për studentët e huaj. **[49 fq.15; 50; Shpjegime 7]** Institucioni nuk ka politikë gjithëpërfshirëse të shkruar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni se KUB-ja synon zhvillimin e një politike zyrtare integrimi në të ardhmen e afërt. **[M13]** Mungesa e politikës së shkruar të integritit për stafin dhe studentët e huaj përbën **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që në të ardhmen e afërt t'i kushtohet vëmendje hartimit dhe zbatimit të politikës për stafin dhe studentët e huaj **[Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një politike të shkruar për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj (pika 1.11; ***Kapitulli III Standardi III.4***)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- kushtimi i vëmendjes nga ana e KUB-së, në të ardhmen e afërt, hartimit zbatimit të një politike për integrimin e stafit dhe studentëve të huaj (pika 1.11; ***Kapitulli III Standardi III.4***)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 KUB-ja ndjek politikën e punësimit të stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. **[RVV fq.21; 13; M12]** Shpallja e vendeve të lira për staf bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkërendim me nevojat përkatëse të departamentit për staf, dhe në përputhje me procedurat e kërkuara për punësimin e stafit. Vendet e lira shpallen në faqen e internetit të KUB-së dhe në zyrën e punësimit. **[RVV fq.21; 29; 6; M12]** KUB-ja ndjek politikën e ngritjes në detyrë të stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, dhe i mbështet ata për çështje financimi. Ndonjëherë, kjo mbështetje garanton mobilitetin e tyre, si në rastin e pjesëmarrjes së stafit akademik në programin e shkëmbimit të Mevlanës, që është një program shkëmbimi për studentët dhe stafin akademik ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Turqi dhe institucioneve të arsimit të lartë të shteteve të tjera. **[RVV fq.21; 13; M12]** Gjatë rekrutimit të stafit akademik, KUB-ja i jep përparësi kandidatëve që kanë studiuar në universitete jashtë vendit. **[RVV fq.21; M11]** **[Kapitulli III Standard IV.1]**
- 2.2 Në fillim të çdo viti akademik, Rektorati organizon një mbledhje me stafin akademik dhe personelin administrativ, për prezantimin e objektivave dhe veprimtarive të ardhshme të KUB-së. Pikat ku përqendrohen mbledhjet lidhen me prezantimin e stafit të punësuar së fundmi dhe ndryshimet e mundshme të planit strategjik. **[RVV fq.22; M12]** Në kuadër të këshillimit të karrierës për studentët e vjetër, dhe nën mbikëqyrjen e Dekanit të Studentëve, stafi akademik viziton shkollat e mesme dhe ndjek të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale. Informacioni i përditësuar për çdo vit akademik vihet në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve, nëpërmjet guidave përkatëse, si Guida e Studentëve dhe Guida e Stafit. **[RVV fq.22; 49; 50; M12]** KUB-ja integron stafin e tij në jetën sociale, nëpërmjet organizimit të konferencave, workshop-eve, seminareve dhe seancave të trajnimit. Megjithatë, ai nuk ka një strategji zyrtare të shkruar për stafin dhe studentët e huaj (shihni pikën 1.11). Njoftimet për këto aktivitete bëhen nëpërmjet adresave personale të emailit, faqes së internetit dhe rrjeteve sociale. **[RVV fq.23; sistemi BIS; M12]** **[Kapitulli III Standard IV.2]**
- 2.3 KUB-ja ka miratuar një rregullore të veçantë për vlerësimin e stafit akademik në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit akademik. Rregulloret përcaktojnë metodologjinë dhe procedurën e anketimeve dhe vlerësimeve. Këto përfshijnë vlerësimet e studentëve për stafin akademik, vetëvlerësimin e stafit dhe vlerësimin e stafit nga eprorët e tyre. **[RVV fq.23; 52; 10; M2; M5; M6; M12]** KUB-ja e trajnon stafin akademik, nëpërmjet shkëmbimeve me universitete në vend dhe ato ndërkombëtare, veçanërisht në kontekstin e lëndëve të veçanta që ai zhvillon, si shkenca e teologjisë. Mobiliteti i mundësuar nga projekti Mevlana është shembulli më i mirë i kësaj praktike. **[78; M12]** KUB-ja nxit gjithashtu stafin e tij akademik të botojë rezultatet e kërkimit dhe artikuj, dhe këtë mund ta zhvillojnë në dy revistat e universitetit të shqyrtuara nga kolegët, përkatësisht Revista Shkencore e Shkencave të Edukimit, dhe Revista Shkencore Beder e Shkencave Humane. **[23; M12]** **[Kapitulli III Standard IV.3]**
- 2.4 Stafi akademik, në bashkëpunim me studentët, organizon veprimtari sociale. Këto veprimtari përfshijnë fushatat për dhurimin e gjakut, mbledhjen e parave për fëmijët që vuajnë nga kanceri dhe mbështetjen e infrastrukturës teknologjike për shkollimin në shtëpi, për fëmijët e ngujuar për shkak të gjakmarrjes në Shkodër. **[RVV fq.24; 58; M12]** KUB-ja nxit dialogun social tërësor, si për shembull veprimtaritë e shumta që ai organizon me komunitetet e tjera fetare, duke përfshirë shkollat që ofrojnë edukim fetar. **[RVV fq.24; 106; M12]** KUB-ja ndjek politikën e shlyerjes së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për studentët dhe stafin e saj, nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit me Spitalin Amerikan. Ai ka punësuar gjithashtu një mjek i cili qëndron në ambientet e KUB-së katër orë në ditë **[RVVfq.24; 40; M9]** **[Kapitulli III Standard IV.4]**
- 2.5 KUB-ja ka parashikuar rregulla për caktimin e përgjegjësive të strukturave të saj sipas funksioneve të tyre përkatëse. Si rrjedhojë, në përputhje me ligjin e ri nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", KUB-ja përcakton funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative në Statut dhe rregulloret e tij. Së shpejti duhet të fillojë funksionimi i Bordit të Administrimit sipas strukturës së re, siç e parashikon edhe ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili aktualisht funksionon ende si

Këshilli i Lartë sipas strukturës së tij të vjetër.[RVV fq.25; 4; 5; M13] **[Kapitulli III Standard II.2]**

- 2.6 Para se të bëheshin ndryshimet me anë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, projektbuxheti përgatitej nga Zyra e Financës në bashkëpunim me Kancelarin e KUB-së, dhe i dërgohej për miratim Këshillit të Lartë. Më pas, drejtuesit ia delegonin buxhetin e KUB-së departamenteve dhe njësisive.[RVV fq. 25; M2; M10; M13] Me ndryshimet në ligjin e ri, janë departamentet dhe njësitë ato që propozojnë nevojat e tyre, të cilat më pas i dërgohen Rektoratit. Rektorati i paraqet ato në Senat si nevoja të të gjithë institucionit. Më pas, Senati miraton në parim buxhetin para se ai të kalojë për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit.[M2; M3; M4; M10; M13]**[Kapitulli III Standard VI.1]**
- 2.7 Shpërndarja e burimeve financiare bëhet nga Këshilli i Lartë sipas buxhetit paraparak të miratuar dhe të pranuar nga të gjitha njësitë.[RVV fq.25; M3; M4; M10; M13] KUB-ja iu përmbahet rregullave të kontabilitetit, veçanërisht standardeve kombëtare të kontabilitetit. Ai ruan të dhënat e tij në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.[RVV fq.25; M13] KUB-ja është institucion privat i arsimit të lartë, dhe rregullat për menaxhimin e brendshëm e tij përcaktohen në aktet që ai miraton.[RVV fq.25; M13] Statuti i KUB-së përcakton procedurën e alokimit dhe vijimësisë së buxhetit të tij.[RVV fq.25; 1 Nenet 12, 15 dhe 23]**[Kapitulli III Standard VI.2]**
- 2.8 Duke qenë një institucion privat jofitimprurës, KUB-ja nuk i nënshtrohet drejtpërdrejt auditimit financiar nga agjencitë shtetërore. Megjithatë, në fund të çdo viti, KUB-ja e dorëzon raportin e tij vjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duke përfshirë buxhetin e vitit të mëparshëm, si dhe projektbuxhetin për vitin akademik pasardhës. Këshilli i Lartë mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe planin e investimit, si dhe çdo veprimtari tjetër financiare.[RVV fq.26; 57; 1, Neni 12; M13] Paraqitja e përvitshme i Raportit Vjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ku KUB-ja, krahas buxhetit të vitit të mëparshëm, paraqet edhe buxhetin e vitit pasardhës, tregon se ajo merr parasysh nevojat e saj të mësimdhënies dhe shërbimeve cilësore për studentët.[RVV fq.26; 1, Neni 12, pika 5; 57, pika 5; M13].**[Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.9 Njësitë administrative përgjegjëse për zbatimin e sistemit të informacionit dhe menaxhimit të informacionit janë Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Zyra e Teknologjisë së Informacionit. Detyrat e këtyre janë të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit Akademik.[RVV fq.26; 5, Nenet 34, 39 dhe 78; M13]. KUB-ja përdor Sistemin e mirëzhvilluar të Informacionit të Beder (BIS), për të lehtësuar menaxhimin e veprimtarive të saj. Studentët dhe stafi kanë akses në këtë sistem. Ndërmjet shumë funksioneve të tjera, sistemi menaxhon regjistrimin e studentëve dhe organizimin e procesit mësimdhënës, duke përfshirë regjistrimin e notave të tyre. Studentët dhe stafi e konsiderojnë të dobishëm sistemin.[RVV fq.26; M5; M6; M12; M13; demonstrim i BIS] Faqja e internetit e KUB-së përmban informacione thelbësore, si p.sh. programet e ofruara të studimit; tarifat e shkollimit; dhe dy aktet bazë të institucionit, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme [RVV, p 23; 57, pika 3.3; <http://ww.beder.edu.al>] **[Kapitulli III Standard VII.1]**
- 2.10 Infrastruktura teknike dhe teknologjike e KUB-së mundëson procesin efikas të mësimdhënies dhe mësimnxënies. [RVV fq.27; M9] Secili anëtar i stafit ka një hapësirë në zyrë që është e pajisur me një kompjuter me lidhje interneti, një telefon dhe raftë për mbajtje të sendeve. Studentët kanë akses në kompjuterat e bibliotekës dhe në sallat e laboratorit. KUB-ja nuk ofron programe të të nxënies në distancë. Shihni gjithashtu pikën 5.5.[RVV fq.27; 30; M9] **[Kapitulli III Standard VII.2]**
- 2.11 KUB-ja ka një regjistër të pasurive të saj të paluajtshme. Aktualisht, ai i ushtron veprimtaritë e tij në ambiente të marra me qira për një periudhë 10 vjeçare, deri në vitin 2021.[RVV fq.27; 103] KUB-ja synon që në një të ardhme të afërt të zhvendoset në ambiente të reja, dhe për këtë qëllim ka blerë truall për ndërtimin e kampusit të saj të ri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të identifikonte struktura brenda universitetit për menaxhimin e këtij zhvillimi.[RVV fq.28; 95] **[Kapitulli III Standard VII.3]**
- 2.12 KUB-ja dorëzon pesë kopje të të gjitha botimeve të tij në Bibliotekën Kombëtare, për të ruajtur trashëgiminë e saj akademike, kulturore dhe shkencore. Ai e mbështet stafin e tij të marrë pjesë dhe të angazhohet në projekte të kërkimit shkencor. Ai jep gjithashtu shpërblime

vjetore për arritjet akademike në bazë të treguesve transparentë të përcaktuar në direktivën e tij të brendshme.[RVV fq.28; 65; M12; M13] KUB-ja ndjek politikën e ruajtjes dhe zhvillimit të pasurisë së saj akademike, kulturore dhe shkencore. Rregullorja për Arkivin përcakton rregullat bazë për funksionimin e arkivit të KUB-së, për të gjitha dokumentet e organeve drejtuese, njësisë kryesore dhe atyre administrative.[RVV fq.28; 12; M12] **[Kapitulli III Standard VII.4]**

- 2.13 KUB-ja ka infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë së saj. Ambientet janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për ofrimin e programeve të saj, siç është ndriçimi i përshtatshëm natyral, tabelat interaktive, kompjuterat, videoprojektorët dhe sistemi i ajrimit. Ambiente të tjera, si sallat e konferencave dhe bibliotekat lehtësojnë procesin e mësimdhënies. KUB-ja ka ambiente shtesë për stafin e tij akademik, në proporcion me numrin e pedagogëve (shihni pikën 2.10).[RVV fq.28; 107; M9] **[Kapitulli III Standard VII.5]**
- 2.14 KUB-ja kryen disa funksione të interesit të përbashkët. Për shembull, ai ofron shërbime si zhvillimi i provimeve të gjuhës angleze, duke përfshirë TOEFL dhe APTIS. [RVV fq.29; 100] **[Kapitulli III Standard VII.6]**
- 2.15 KUB-ja e ushtron veprimtarinë e saj në dy godina, A dhe B. Në përgjithësi, infrastruktura përmbush kriteret e përcaktuara në ligj.[96; M9] Ai e përdor godinën A kryesisht për veprimtaritë mësimdhënëse të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Shkencave të Edukimit, dhe departamenteve të tyre.[RVV fq.31-33; M9] Në godinën A, ndodhen gjithashtu zyrat e stafit akademik dhe personelit administrativ; biblioteka, sekretaritet, zyra e mjekut, ndërsa në katin e tretë, ndodhen zyrat e Fondacionit. Sallat në godinën A janë të mirëpajisura (shihni pikën 2.13).[M9] Godina B ka disa salla, një palestër, dhe një sallë konferencash. Sistemet e ajrimit dhe ndriçimit të kësaj godine duhet të ishin më të mira, duke pasur parasysh se disa prej sallave janë nëntokë. Megjithatë, KUB-ja po ndërmerr masa për monitorimin e cilësisë së ajrimit dhe ndriçimit, nëpërmjet angazhimit të ekspertëve të jashtëm.[M9] Sipas numrit aktual të studentëve të regjistruar, universiteti ofron një sipërfaqe mesatare prej 7.6 m² për student. KUB-ja i përmbush normat teknike të ndriçimit natyral, dhe godina ka dalje dhe shkallë emergjence. Ai ka gjithashtu një burim alternativ për furnizimin me energji elektrike.[RVV fq.30-31; M9] **[Kapitulli III Standard V.1]**
- 2.16 KUB-ja mban dokumentacion të plotë të veprimtarisë së saj akademike në format të shtypur dhe elektronik.[RVV fq.31; 108; M9] Ai ka një rregullore të veçantë për arkivimin dhe menaxhimin e dokumentacionit. Zyra e Sekretarisë Mësimore të KUB-së është përgjegjëse për përgatitjen dhe arkivimin e të gjitha të dhënave përkatëse në përputhje me aktet nënligjore dhe Rregulloret për Zyrën e Sekretarisë Mësimore.[RVV fq.31; 14; M10] Institucioni mban një regjistër të studentëve në format të shtypur dhe elektronik për ruajtje të përhershme, i cili përmban notat e studentët gjatë gjithë programit të studimit, të dhëna për diplomën apo diplomat e marra, suplementin e diplomës dhe numrin e amzës. Të gjitha këto bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi. [RVV fq.31; M5; M6; M10] **[Kapitulli III Standard V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 KUB-ja ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe kapacitetet e saj. Ai e informon publikun në lidhje me to, nëpërmjet faqes së tij të internetit dhe mënyrave të tjera, siç janë fletëpalosjet, guidat, pjesëmarrjet në panaire, vizitat në shkolla dhe ditët e hapura. **[RVV fq.33; M5; M6]** KUB-ja ka përcaktuar fushën e shkencave humane dhe sociale si prioritet të krijimit të profilit të tij. Ai ofron programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave siguron se këto programe studimi zhvillohen për përmbushjen e të gjithë komponentëve të përcaktuar në specifikimet përkatëse. **[RVV fq.33; E87; M5; M6; M12]** KUB-ja ka miratuar, nëpërmjet Senatit Akademik dhe Këshillit të Lartë, rregullore për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, si edhe provimet për vlerësimin e metodologjisë së tij mësimdhënëse dhe vlerësimin e arritjeve të studentëve. **[RVV fq.33; 6; 7; M5; M6] [Kapitulli I Standard I.1]**
- 3.2 KUB-ja nuk ofron mundësi për zhvillimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, siç janë kurset afatshkurtra të posaçme për zgjerimin ose përditësimin e njohurive si mënyrë e të nxënit gjatë gjithë jetës. **[M5; M6]** Megjithatë, ai ka krijuar Zyrën e Planifikimit të Karrierës, e cila organizon caktimin e studentëve të saj në praktikë profesionale ose stazhe. **[M7] [Kapitulli I Standard I.2]**
- 3.3 Programet e studimit të KUB-së ofrohen në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit. **[RVV fq.34; 33, Kapitulli V]** Oferta akademike e programeve të studimit të KUB-së përfshin vazhdimisht informacionin për diplomat e lëshuara në përfundim të studimeve. Guida e Studentëve, kontratat e studentëve, faqja e internetit e programit përkatës dhe mbledhjet e organizuara në kuadër të mbështetjes së ofruar nga KUB-ja, ofrojnë informacion për titullin e diplomës dhe suplementin e saj. **[RVV fq.34; 50; M5; M6] [Kapitulli I Standard I.3]**
- 3.4 KUB-ja i zhvillon politikat e saj në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në Planin Strategjik të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për Arsimin e Lartë. **[RVV fq.35; M3; M4]** Ai pranon studentë nga shtete të ndryshme, ofron programe në gjuhë të huaja, në gjuhë dhe letërsi angleze, dhe gjuhë e letërsi turke, si dhe ofron studime ndërdisiplinore me një diplomë të përbashkët, si ajo në Shkencat Islame dhe Edukim. **[RVV fq.35; M5; M6] [Kapitulli I Standard I.4]**
- 3.5 KUB-ja përcakton ngarkesën mësimore të pedagogëve në përputhje me kriteret e specifikuar në aktet nënligjore në fuqi. Ai mbështet anëtarët e rinj të stafit akademik që studiojnë në programet e Doktoraturës, duke iu reduktuar orët e tyre të mësimdhënies, për t'iu lejuar kohë për veprimtarinë kërkimore. Planifikimi i ngarkesës mësimore lidhet gjithashtu ngushtësisht me detyrat menaxheriale të kryera nga anëtarë të caktuar të stafit akademik, si përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët. **[11]** Kriteret e përlogaritjes së ngarkesës për stafin akademik të punësuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në të dyja ciklet e programit janë përcaktuar në Direktivën e Ngarkesës Mësimore. Ngarkesa mësimore e pedagogëve që tejkalon maksimumin ligjor financohet nga burimet personale të KUB-së. Direktiva përcakton pagesën për orët jashtë orarit të punës dhe kufijtë për orët shtesë. **[RVV fq.35; 25; M11; M12] [Kapitulli I Standard I.5]**
- 3.6 Programet, kurrikulat dhe syllabuset janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të KUB-së. Gjatë orës së parë të çdo moduli, pedagogët i informojnë me hollësi studentët e tyre për syllabusin, planin e kursit dhe mënyrat e vlerësimit. **[RVV fq.35; M5; M6; M12]** Objektivat e programit i dorëzohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe publikohen në faqen e internetit të secilit departament. Këto detaje përcaktohen në rregulloret përkatëse të programit të studimit. **[RVV fq.35; 19; M5; M6]** KUB-ja i ka të përcaktuara qartë kriteret e pranimit, të cilat janë përfshirë në Rregulloren Bazë dhe në rregulloren për studimet Bachelor dhe provimet. **[RVV fq.35; M5] [Kapitulli I Standard I.6]**
- 3.7 Programet e studimit lejojnë kalimin progresiv nga cikli i parë në atë të dytë, bazuar në kuadrin ligjor dhe Procesin e Bolonjës. **[RVV fq.36; M6]** Për shembull, një i diplomuar në ciklin e parë në drejtësi do të ketë mundësinë të vazhdojë studimet e tij ose të saj në ciklin e dytë Master i Shkencave ose Master Profesional në një prej kurseve të ofruara nga KUB-ja. **[RVV fq.36; M6]** Programet e studimit të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë, parimet dhe metodat

- e përgjithshme shkencore, dhe aftësitë formuese të veçanta. **[RVV fq.36; M5]** Studentët informohen dhe këshillohen për mundësinë e transferimit të programeve të studimit ose krediteve të fituara gjatë studimeve të tyre. KUB-ja respekton dhe zbaton kriteret dhe dispozitat ligjore në përputhje me rregulloren e saj të brendshme dhe ligjin për arsimin e lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi disa studentë që i kanë transferuar studimet e tyre në KUB, dhe e përshkruan atë si përvojë pozitive. **[RVV fq.36; 15; M5] [Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.8 KUB-ja i mbështet studentët nëpërmjet veprimtarive orientuese dhe tutorit të saj. Në nivel institucional, ai ka krijuar postin e Dekanit të Studentëve. Çdo departament cakton një person që është përgjegjës për këshillimin e karrierës së studentëve dhe që punon nën koordinimin e Dekanit të Studentëve. Gjithashtu, çdo departament cakton një këshilltar akademik për një grup studentësh, i cili mbështet procesin e arsimimit të studentëve të grupit në fjalë. **[RVV fq.36-37; 6, Neni 6; 55; M5; M6; M12]** KUB-ja përdor një larmi metodash të mësimdhënies në varësi të interesave të studentëve të saj. Studentët u shprehën për përdorimin nga ana e pedagogëve të prezantimeve ilustruese, debatit ndërveprues dhe vizitave në institucione të ndryshme, si vizitat e studentëve të drejtësisë në gjykatë. KUB-ja ka gjithashtu si prioritet rekrutimin e stafit akademik me tituj dhe grada shkencore, jo vetëm për përmbushjen e kriterëve ligjore për numrin e anëtarëve të stafit me grada dhe tituj, por edhe për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Disa prej tyre kanë përfunduar studimet e tyre të doktoraturës jashtë vendit, kryesisht në universitete të Turqisë. Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë zhvillon 83% të mësimdhënies në programet e ciklit të parë. **[RVV fq.37; M3; M4; M12][Kapitulli I Standard I.8]**
- 3.9 Stafi akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e programit të studimit. **[RVV fq.37; 86; M12]** Programet e studimit Master i Shkencave hartohen për të mbështetur politikat e KUB-së kundrejt kërkimit. Ndonjëherë, sektori privat dhe shoqëritë shtetërore ndihmojnë me përmbushjen e modulit të praktikës profesionale dhe me projekt-teza për studentët. Studentëve iu ofrohen mundësi stazhi gjatë muajve të verës dhe KUB-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shoqëri të sektorit privat në Shqipëri dhe Turqi për lehtësimin e tyre. Gjatë vitit akademik 2015-2016, 74 studentë përfunduan stazhet e tyre verore në Shqipëri. **[RVV fq.38; 92; M7]** Punësimi i studentëve pas diplomimit të tyre mbikëqyret nga Zyra e Dekanit të Studentëve dhe monitorohet nga Zyra e të Diplomuarve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës. Sipas statistikave të KUB-së, 87% e ish studentëve të tij janë të punësuar, por jo të gjithë ata janë punësuar në profesionet për të cilat ata kanë studiuar. **[RVV fq.38; 85; M13]** Si pjesë të politikës së tij, në programet e tij të Master Profesional dhe kërkimit, KUB-ja rekruton përfaqësues nga biznesi ose industria, siç është Drejtori i Burgut të Grave. **[M7] [Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.10 Programet e studimit të KUB-së ofrohen në përputhje me Procesin e Bolonjës. **[RVV fq.38; M5; M6]** Përmbajtja e kurrikulës organizohet në module dhe vlerësohet në kredite evropiane sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ajo është gjithashtu e disponueshme edhe në faqen e internetit, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë angleze. **[RVV fq.38; M5; M6]** Diplomat e lëshuara me përfundimin e programeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen nga suplementi i diplomës. **[RVV fq.38; 73; M5; M6]** KUB-ja zhvillon programe studimi që lehtësojnë mobilitetin e studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi dy studentë që kishin marrë pjesë në një program shkëmbimi të programit Erasmus, të cilët u shprehën se ishin të kënaqur me përvojën e tyre. Ata ishin studentë të drejtësisë dhe kishin ndjekur një semestër në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Ankarasë. Kreditet që ata kishin fituar njiheshin edhe nga KUB-ja. **[RVV; fq.39; 17; M5; M6] [Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.11 Programet e studimit të KUB-së përfshijnë përgatitjen e studentëve dhe prezantimin e projekteve të kërkimit shkencor sipas rregulloreve të ndryshme të studimit për temën e diplomës, tezën dhe disertacionin. Që prej vitit akademik 2011-2012, KUB-ja ka organizuar pesë konferenca studentore vjetore, ku studentët kanë prezantuar punimet e tyre shkencore. Organizimi dhe menaxhimi i këtyre konferencave tashmë po i delegohet studentëve, sigurisht nën kujdesin dhe mbështetjen e KUB-së. **[RVV; fq.40; 75; 22; M5; M6][Kapitulli I Standardi I.11]**

3.12 Programet e studimit të KUB-së ofrojnë module të veçanta me karakter vërtet profesional dhe njohuri në fushat socio-ekonomike. Ato përfshijnë njohuri për sipërmarrjen, praktikat profesionale dhe stazhet. Të gjitha programet e studimit bazohen në kërkesat ligjore për të zhvilluar modulën e praktikës profesionale. Për shembull, studentët e drejtësisë e zhvilluan praktikën e tyre profesionale në gjykata, ndërsa studentët e komunikimit e zhvilluan atë në një stacion radiofonik. Kjo përvojë krijon shpesh mundësi për punësim në të ardhmen me anë të këtyre kontakteve fillestare. **[88; M5; M6] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 KUB-ja i ofron të gjitha programet e publikuara të studimit. Institucioni ka një sistem që garanton ofrimin e programeve të studimit në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar. Në fillim të çdo semestri, departamentet miratojnë ngarkesën mësimore, materialet që do të shpërndahen, dokumentet përkatëse dhe përditësimet e kurrikulës. Më pas, procesi auditohet nga një grup pune, që ngrihet nga Rektori. **[64]** KUB-ja e mbështet formimin profesional dhe praktik të studentëve nëpërmjet Qendrës së Medias dhe Komunikimit, Labororit të Gjuhëve të Huaja, Labororit të Informatikës dhe Sallës së Gjyqit. **[RVV fq.42; M9]** KUB-ja i administron praktikat profesionale dhe stazhet e studentëve nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës, e cila mbikëqyret nga Dekani i Studentëve. Prosesi ndahet në dy faza: në aplikimin e studentëve dhe raportin e stazhit. **[Shpjegime 4.20; B17; B18]** Gjithashtu, institucioni pritës vërteton kryerjen e stazhit. **[Shpjegime 4.20; B19]** Disa programe, si p.sh. ato në mësimdhënie përdorin formularë të posaçëm për monitorimin e procesit. **[RVV fq. 42; 5, Neni 5; 67]** Ndonëse vlerësohen veçmas, stazhet e studentëve nuk i janë nënshtruar ende asnjë rishikimi apo vlerësimi të brendshëm të përgjithshëm. **[67; Shpjegime 4.21]** Gjatë përgatitjes së disertacionit ose temës së Masterit, studentët udhëhiqen nga këshilltarët akademikë, të cilët përgatisin edhe një raport për këtë proces. Studentëve iu kërkohet ta ta takojnë mbikëqyrësin e temës së tyre të diplomës të paktën pesë herë gjatë semestrit. Mënyra e përgatitjes dhe udhëheqjes së temës së diplomës parashtrohet në rregullore. **[RVV fq.42; 7; Shpjegime 4.6]** Të gjitha programet e studimit mbështeten nga biblioteka dhe burimet e saj. **[RVV fq.42; 30; M9]** Shihni pikat 5.5 dhe 5.6. **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 KUB-ja i pajis studentët që përmbushin të gjitha detyrimet e programit të studimit me diplomën përkatëse. Rregullat dhe rregulloret e KUB-së për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, duke përfshirë edhe procedurat për provimet dhe diplomimin, përshkruhen në rregulloret zyrtare, **[6; 7]** të cilat gjenden në Guidën e Studentit dhe në faqen e internetit. **[50, fq. 23-24, fq. 28; <http://beder.edu.al/sh/fcontent/default/rregulloret-akademike-administrative-19-14/187/204>, 29 prill ,2017]** Gjithashtu, me Vendim Senati është miratuar një direktivë e posaçme për provimet. **[51; Shpjegime 4.7; B11]** Pavarësisht se institucioni ka një rregullore të përgjithshme për shkeljet akademike të studentëve, ku përfshihet edhe kopjimi në provim, shumica e studentëve të anketuar shprehen se, kjo e fundit përbën problem. **[20, Nenet 9- 10; Anketimi i Studentëve 9.ii]** Në rregulloret e universitetit, përfshihen edhe ankesat ndaj rezultateve të provimeve. **[6, Neni 23; 7, Nenet 33/a dhe 34/a]** Studentët kanë të drejtë ta ankimojnë rezultatin brenda pesë ditëve pas publikimit të tij, përmes dorëzimit të një kërkesë me shkrim në Sekretarinë Mësimore. , Përpara se t'i nënshtrohet procesit të shqyrtimit të këshillit të departamentit pa praninë e pedagogut të lëndës, ankimi trajtohet fillimisht nga ky i fundit, i cili kontrollon për ndonjë gabim të mundshëm në llogaritje. **[RVV fq.43; 6, Neni 23; 7, Nenet 33/a dhe 34/a]** Studentët pohuan se kishin akses konfidencial në rezultatet e provimeve nëpërmjet Sistemit të Informacionit Beder, i cili ofron me efikasitet edhe informacione të tjera, si p.sh rreth orareve mësimore, zgjedhjes së leksioneve dhe monitorimit të frekuentimit. **[RVV fq. 43; M6]** **[Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 KUB-ja siguron përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të saj të studimit. Institucioni ndjek politika dhe procedura të përshtatshme për sigurimin e cilësisë, që përcaktohen në rregullore. Përpara miratimit të ligjit të ri, KUB-ja kishte Këshillin e Sigurimit të Cilësisë, por pas procesit të riorganizimit, ai u zëvendësua nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që menaxhon çështjet operationale, dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit, që është përgjegjës për vizionin e sigurimit të cilësisë. **[RVV fq. 43-44; 2, Nenet 28-29; 8; 9; <http://qau.beder.edu.al> – linku i provuar më 29/04/17; M3; M4]** Njësia mbikëqyr dhe monitoron disa anketime, duke përfshirë edhe anketimin e kënaqshmërisë së studentëve, anketimin e kënaqshmërisë së stafit akademik dhe anketimin e kënaqshmërisë së personelit administrativ. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa vetëm rezultatet e anketimit të kënaqshmërisë së studentëve, të cilat ishin të gjitha pozitive. **[RVV fq.23, 29, 44; 10; 52; 74; 81; Shpjegime 4.8]** Pedagogët vlerësohen në mënyra të ndryshme, si p.sh. nëpërmjet anketimeve të studentëve, vetëvlerësimeve dhe vlerësimeve vjetore nga eprorët, të cilët vlerësojnë veprimtarinë e tyre mësimdhënëse dhe kërkimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se rezultatet e vlerësimeve të studentëve nxisnin shumë

ndryshime. Gjithashtu, ato shërbenin si bazë për vlerësimet vjetore të stafit akademik dhe ndihmonin në përcaktimin e objektivave për vitin e ardhshëm. Anëtarët e stafit akademik përmendën disa ndryshime kurrikulare, duke përfshirë edhe rivendosjen e ekuilibrit ndërmjet punës teorike dhe asaj praktike të përbajtjes së përgjithshme, ku i jepej përparësi kësaj të fundit, si dhe futjen e këshillimit me kolegët. Nga ana tjetër, midis ndryshimeve kurrikulare që përmendën studentët, përfshihej zëvendësimi i vlerësimit të mbështetur vetëm në provim me vlerësimin e vazhdueshëm. **[RVV fq.44; 74; 10; M6; M12]** Rezultatet e provimeve shpallen nëpërmjet sistemit BIS të universitetit, ndërsa rezultatet e konkurseve, si p.sh Konkursi i Projektit Inovator Bachelor ose çmimi “Teza më e mirë e Master-it”, publikohen në mënyrë anonime në faqen e internetit të universitetit. **[RVV fq.44; 105; M5]** Ndryshimet e programeve, duke përfshirë edhe përmirësimet që vijnë si rrjedhojë e vlerësimeve të studentëve ose personelit, mbikëqyren nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. **[RVV fq.44; 24]** Secili modul vlerësohet nëpërmjet anketimeve të studentëve, rezultatet e të cilave jo vetëm që aksesohen nga pedagogët, por edhe merren parasysh gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.. Si shembuj të përmirësimeve të fundit, mund të përmenden përditësimet e kurseve të drejtësisë, për të pasqyruar ndryshimet e legjislacionit shqiptar, si dhe për të përshtatur mundësitë e e gjuhën dhe vlerësimin, për përfshirjen e një numri më të madh esesh me tema aktuale dhe praktike. **[RVV fq.44; Shpjegime 4.9; B12; M5; M6; M12]** Pjesë e vlerësimit të programit është edhe punësimi i të diplomuarve. KUB-ja merr parasysh feedback-un e punëdhënësve në ndryshimin e kurrikulës, si p.sh. përfshirja e aspekteve të medias sociale në një program gazetarie, që ishte sugjerim i një gazetari profesionist, dhe hapja e programeve të reja, si kursi i ri për dijetarët e shquar shqiptarë. **[RVV fq.44; 84; M7] [Kapitulli I Standardi II.3]**

4.4 KUB-ja ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Krahas masave të parashtruara në paragrafët e mësipërm, në fillim të çdo viti akademik të gjithë departamentet, rishikojnë programet që ofrohen. Secili pedagog duhet t'i përditësojë syllabuset në sistemin BIS në përshtatje me zhvillimet e reja të lëndëve dhe feedback-un e përfutur nga anketimet e studentëve. **[RVV fq.44; Shpjegime 4.10; B13; M10]**, KUB-ja i organizon programet e trajnimit për stafin akademik nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore. Në faqen e internetit, janë renditur dhjetë veprimtari të zhvilluara në vitin 2014-2015. Për vitin 2016-2017, u organizuan tetë trajnime, të ofruara nga konsulentë të jashtëm rreth: mësimdhënies efikase në auditor, mbikëqyrjes së temës së diplomës dhe botimit të një artikulli shkencor. Anëtarët e stafit akademik, që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, ishin të informuar rreth mundësive të tjera për zhvillimin profesional në vazhdim, nëpërmjet shkëmbimeve në mësimdhënie dhe lidhjeve me industrinë e ndryshme, si p.sh me atë të medias. **[RVV fq. 44-45; <http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14> – është kontrolluar më 30/04/17 dhe funksionon; M2; M3; M4; M11; M12; M13]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e monitoron cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet mekanizmave si p.sh anketimeve të studentëve. **[RVV fq. 45; 2, Neni 8, 1.j dhe Nenet 28-29, Neni 29, b përmend një Kod Cilësie; M5]** Institucioni mbështet disa metoda mësimdhënieje, p.sh. në disa klasa jepen mësimet rreth aftësive të prezantimit, aftësive gazetareske për studentët e shkencave të komunikimit, aftësive për seancat gjyqësore për studentët e drejtësisë, si dhe ofrohet një ambient i posaçëm për studentët e shkencave islame. **[Shpjegime , 4.11:M2]** Për më tepër, KUB-ja ofron trajnime për t'i përditësuar pedagogët në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe metodologjitë e mësimdhënies. **[<http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14>; Shpjegime 4.3 dhe 4.12] [Kapitulli I Standard II.4]**

4.5 KUB-ja e realizon kërkimin e tij shkencor përmes departamenteve, të cilët kanë lidhur marrëveshje të shëndosha për monitorimin dhe mbështetjen e kërkimit të ndërmarrë nga stafi akademik. Departamenti është njësia bazë e universitetit dhe përfshin fusha kërkimore dhe disiplina shkencore homogjene. Departamentet dhe grupet e kërkimit ngrihen dhe drejtohen në përputhje me Statutin. **[RVV fq. 45; 1, Nenet 30-31; 2, Nenet 45, 46, 47 dhe 48; B16]** Çdo semestër, departamenti cakton ngarkesën mësimore të stafit akademik, gjatë llogaritjes të së cilës saj merr parasysh kërkimin shkencor individual që ndërmerr stafi. **[77; 25; Shpjegime 4.18]** Në fund të çdo viti akademik, departamentet e monitorojnë dhe rishikojnë veprimtarinë e kërkimit shkencor nëpërmjet vlerësimeve të stafit akademik. **[52, Seksioni A.1]** Gjithashtu, KUB-ja financon veprimtarinë shkencore në nivel qendror, në mbështetje të urdhrave të brendshëm dhe duke respektuar parimin e lirisë akademike. **[RVV fq. 45-46; 23; 65; Shpjegime 4.17; B15]** Liria akademike përkufizohet si 'liria për të ndërmarrë veprimtari kërkimore shkencore, mësimdhënëse, dhe botuese, si dhe për të ushtruar të lirinë e fjalës,

mbështetur në standardet e kërkimit shkencor pa ndërhyrje apo penalitete dhe pa paragjykuar rezultatet përfundimtare të arritura me anë të studimit të ndërmarrë. **[RVV fq. 47; 3, Neni 23-24 (në veçanti)]** Departamentet përgatisin raporte vjetore, të cilat përfshijnë të dhëna për veprimtarinë shkencore, si p.sh botimet, konferencat, si dhe analizën e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, **[RVV fq. 46; 72, 6, fq. 387-390; 7, fq. 390-391]** por nuk përfshijnë vlerësimet e veprimtarisë kërkimore shkencore, që kryhen për të përcaktuar vijimësinë ose ndërprerjen e financimit. Shumica e rezultateve kërkimore që janë përfshirë në raportin vjetor model, janë përfutur nga veprimtaritë e ndërmarra nga stafi i brendshëm i institucionit. Departamentet kanë një procedurë të posaçme për hapjen, mbylljen ose shkrirjen e tyre. Fillimisht, këshilli i fakultetit i paraqet një propozim Senatit Akademik, i cili nëse e miraton pas procesit të shqyrtimit, ia përcjell më pas për miratim përfundimtar Këshillit të Lartë. **[RVV fq. 45] [Kapitulli III ,Standardi I.1]**

4.6 KUB-ja nxit zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor si më poshtë, por me përjashtim të pjesëmarrjes së personelit në konferenca, suksesi ika qenë i kufizuar. Institucioni e përkrah kërkimin shkencor nëpërmjet njësive të tij, si p.sh qendrave të kërkimore-zhvillimore, Zyrës së Kërkimit Shkencor, Qendrës për Kërkuesit e Rinj dhe Komisionit të Ri të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacione (për këtë të fundit, shihni pikën 4.12). **[RVV fq. 46; 3, Neni 4; 22; 47]** Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të KUB-së përkrah bashkëpunimin e këtyre njësive me institucionet dhe qendrat e tjera kërkimore. **[RVV fq. 46; 4, Nenet 21 dhe 22]** KUB-ja ka marrë pjesë në disa konferenca të organizuara në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. **[RVV fq. 46; 90]** Këto përpjekje vërtetojnë angazhimin e institucionit për nxitjen e rezultateve të kërkimit shkencor, të cilat deri më sot, kanë qenë të pakta. **[Kapitulli II Standard I.2]**

4.7 KUB-ja përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor, i cili ka qenë disi i suksesshëm. Fusha e veprimtarisë së Njësive të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë, përmes lehtësimit të përvojës ndërkombëtare të personelit dhe studentëve dhe të integritit të duke studentëve dhe personelit që vijnë nga universitetet jashtë vendit në KUB. **[RVV fq. 46-47; 4, Nenet 21 dhe 22]** Ndër shembujt e shkëmbimit të stafit të KUB-së përmendet Rrjeti i Qendrës Universitare Evropiane dhe pjesëmarrja në projektin e Observatorit Universitar Francez të Ekonomisë Vendore, ku merrnin pjesë 70 universitete. **[M10]** Ndër shembujt e shkëmbimit studentor përmenden rastet e shkëmbimit në Turqi dhe Mevlana. **[M6]** Nëpërmjet Njësive të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, KUB-ja ka nënshkruar marrëveshje me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe me qendra kërkimore për pjesëmarrje në konferenca, seminare, projekte kërkimi dhe programe mobiliteti, nëntë prej të cilave kanë përfutur financim. **[RVV fq. 47; 91; C6]** Institucioni ka aplikuar për dy projekte Horizon 2020: një me Universitetin e Burçit, për një projekt gjatë periudhës 2014-2016, **[Shpjegime 4.4; 9]** dhe një tjetër me Terre des Hommes. **[Shpjegime 4.4; B9; B10]** Rezultatet nuk janë përmendur. Një projekt i ardhshëm mund të jetë një konferencë e organizuar me Universitetin Aldo Moro të Barit, në Itali. **[Shpjegime 4.4]** KUB-ja mbështet, dhe për më tepër, ofron incentiva financiare për anëtarët e stafit akademik që botojnë artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare. gjë që ka mundësuar botimin e plot 408 artikujve, pjesa më e madhe e të cilave janë artikuj konferencash dhe nuk janë referuar në revista ndërkombëtare të vlerësuara nga kolegët. **[RVV fq. 47; 23; 65; 86] [Kapitulli II Standard I.3]**

4.8 KUB-ja i përcakton fushat prioritare të kërkimit shkencor, duke përdorur një qasje nga lart poshtë dhe anasjelltas. Si shembull i prioriteteve nga lart poshtë mund të përmendet mbledhja e Rektorit me organet drejtuese dhe marrja e vendimit për të hapur një program për Studimet Islame, ndërsa si shembull i qasjes nga poshtë lart mund të përmendet rasti i vendimeve të marra nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit për hapjen e bibliotekave të vogla në shkolla dhe burgje. **[M1]** Përgjegjësi i përgjithshëm për kërkimin shkencor është Zëvendës Rektori. **[RVV fq.47; 2, Neni 49, 2.d]** Pasi konsultohet me drejtuesit e fakultetit dhe përgjegjësit e departamenteve, Zyra e Kërkimit Shkencor përgatit planin e veprimit dhe axhendat e kërkimit, të cilat, i paraqiten Rektoratit dhe më pas Senatit për miratim. **[Shpjegime 4.13]** Prioritetet përcaktohen në Planin Strategjik, të cilat janë të përgjithshme dhe nuk rendisin rezultate specifike. **[33; 5.3, fq. 449-450; M11]** Në Raportin Vjetor, përmenden politikat e kërkimit dhe disa prej rezultateve, por mënyra se si ato lidhen me prioritetet e Planit Strategjik nuk është e plotësisht qartë. **[B4; 4.1.a fq. 44-45] [Kapitulli II Standardi I.4]**

- 4.9 KUB-ja i zbaton prioritetet e kërkimit shkencor. Në RVV shprehet qartë se disa prej prioriteteve të kërkimit shkencor financohen nga buxheti i vetë institucionit, [RVV fq.48] si p.sh. muzeu i medias, laboratorët e gjuhës së huaj dhe pasurimi i bibliotekës, por këto nuk konsiderohen si prioritete kërkimi nga universitetet mbarëbotërore. Megjithatë, kërkimit i caktohet një zë i posaçëm në buxhet, [M13] dhe KUB-ja ka ngritur shtatë grupe kërkimi brenda departamenteve dhe qendrave kërkimore-zhvillimore, siç përcaktohet edhe në rregullore. [RVV fq.47; 3, Neni 4] Grupet mbulojnë fushat e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane, të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, Studimet e Medias, Shkencat e Edukimit, Studimet Fetare, Turkologji dhe Gjuhë Angleze si Gjuhë e Dytë. [RVV fq.47; Shpjegime 4.19; B16] KUB-ja e punëson, e vlerëson dhe e ngre në detyrë stafin akademik në përputhje me rregulloren e punësimit, në të cilën pedagogëve iu kërkohet të angazhohen në kërkim shkencor. [13, Neni 5, 1.b dhe 2.h; Neni10, 1.b; Neni12; M12; M11] Procesi për përcaktimin e prioriteteve kërkimore shpjegohet në paragrafin e mësipërm, dhe këto prioritete monitorohen, çdo vit sipas metodës së përshkruar në pikën 4.5. [Kapitulli II Standard I.5]
- 4.10 KUB-ja siguron vijimësinë e veprimtarisë kërkimore shkencore të ndërmarrë në mënyrë individuale. Kërkimi shkencor është një prej objektivave strategjikë të Planit Strategjik të Universitetit. Shumica e anëtarëve të stafit akademik angazhohet në veprimtari kërkimore [RVV fq. 48; 33 5.3; 23; Shpjegime 4.14; B4, 4.1.a, fq. 44] dhe botimet e tyre renditen në raportin vjetor. [57 fq. 90-98; B4, fq. 48-58 – kryesisht konferenca] KUB-ja ndjek politikën e bashkëpunimit me organizatat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, kryesisht nëpërmjet organizimit të konferencave vjetore në nivel departamenti dhe fakulteti. [RVV fq. 48; M3; M4] Gjithashtu, ky institucion ndjek politikën e integritetit për kërkuesit e huaj, duke punësuar vazhdimisht pedagogë nga disa vende të ndryshme, si: Turqia, SHBA-ja, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. [RVV fq. 48; M11; M12] Marrëveshjet e lidhura me universitetet partnere të Mevlanës dhe projektet Erasmus + kanë mundësuar shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve. [RVV fq.49; 66] KUB-ja punon ngushtësisht me agjenci kombëtare për kërkim shkencor dhe inovacion, si p.sh. me Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, stafi i së cilës është i trajnuar në zbatimin e projekteve, dhe programin Horizon 2020. [RVV fq.49; B4, 4.1.a, fq.45] Për më tepër, institucioni ka organizuar konferenca për prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015. [Shpjegime 4.5; <http://ich.beder.edu.al/>; <http://iccms.beder.edu.al/> – në funksion më 30/05/17] KUB-ja ka ngritur një Qendër për Kërkuesit e Rinj dhe ka organizuar një konkurs për temën më të mirë. [RVV fq. 49; 41; 105] [Kapitulli II Standard I.6]
- 4.11 KUB-ja i publikon rezultatet e kërkimit shkencor. Ajo ka organizuar dy konferenca të mëdha: njëra në fushën e medias dhe komunikimit, dhe tjetra në fushën e drejtësisë. [RVV fq.49] Të gjitha punimet e konferencës botohen në format libri me ISBN të Bibliotekës Kombëtare dhe në faqen e internetit të universitetit. [RVV fq.50; <http://beder.edu.al/en/content/default/publications-12-2/8/165> – u kontrollua më 30/04/17 dhe u konfirmua që botimet janë publikuara] Në mënyrë periodike, të dyja fakultetet e KUB-së botojnë revista shkencore me ISSN të Bibliotekës Kombëtare: Revista e Shkencave të Edukimit të Beder-it [<http://bjes.beder.edu.al/> (ISSN 2306-0557) – kontrolluar më 30/04/17] dhe Revista e Shkencave Humane Beder. [<http://bjh.beder.edu.al/> (ISSN:2306- 6083) – kontrolluar më 30/04/17] Për më tepër, shihni pikën 4.5 dhe 4.6. [Kapitulli II Standard I.7]
- 4.12 Aktualisht, KUB-ja nuk ndjek politikën e duhur për vlerësimin e rezultateve shkencore. Zyra e saj Kërkimit Shkencor harton dhe menaxhon politikën që drejtojnë ndërmarrjen e kërkimit, si dhe mbikëqyr të gjithë veprimtarinë kërkimore shkencore. [RVV fq.50; 4, Nenet 19, 20 dhe 23; 11] Me përjashtim të procesit të vlerësimit [52; B4, 4.9 (4.1.a pika 2)], menaxhimit individual të projektit dhe [91, 1.1.5, pika 2 dhe 1.2.1 pika 4] vlerësimit për mbështetje financiare, nuk përmendet asnjë mekanizëm mbikëqyrës institucional për vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor [11; 68, Seksion 8.2]. [23] Megjithatë, Zyra e Kërkimit Shkencor do t'i paraqesë Rektorit një udhëzues për përgatitjen e konferencave shkencore, që do të shërbejë si mjet për qëllime vlerësimi. [Shpjegime 4.17] Komisioni i ri i Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion është përgjegjës për mbikëqyrjen e progresit dhe raporteve përfundimtare të të gjitha granteve dhe projekteve kërkimore, si dhe për vlerësimin e rezultatit kërkimor si të mirë, mesatar ose dobët. Më 25 janar 2017, Senati Akademik dha urdhrin për ngritjen e komisionit. Nuk ka asnjë provë që përgjegjësitë e komisionit të jenë miratuar zyrtarisht, ose të jetë kryer vlerësimi i rezultatit të kërkimit shkencor. [RVV fq.50; 21;

47; M11] Mungesa e funksionimit aktual të këtyre mekanizmave thelbësor të vlerësimit për konferencat shkencore, grantet dhe projektet e kërkimit identifikohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i **rekomandon** KUB-së të përqendrohet menjëherë në marrjen e së masave për përmirësimin e vlerësimit të kërkimit shkencor, duke zbatuar tërësisht udhëzuesin përkatës për përgatitjen e konferencave shkencore dhe duke aktivizuar Komisionin e Ri të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion. **[Kapitulli II Standardi I.8]**

4.13 KUB-ja ndjek një politikë për transferimin të rezultateve shkencore. Institucioni mbështet financiarisht veprimtarinë shkencore brenda dhe jashtë vendit, me një buxhet të posaçëm, në përputhje direktivat e tij të brendshme. **[RVV fq. 50; 23, Nenet 5 dhe 6]** Bashkëpunimet me bizneset vendase dhe të huaja kanë sjellë nënshkrimin e 56 marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqëri private kombëtare dhe ndërkombëtare. **[RVV fq. 50; 91; M2]** Një prej rezultateve të përfuara nga marrëveshje të tilla ka qenë projekti i përbashkët kërkimor me Autoritetin e Medias Audiovizive gjatë vitit 2015-2016 dhe 2016-2017. **[RVV fq.50; lccms.beder.edu.al– kontrolluar më 30/04/17]** Punimet, botohen në format libri, njësoj si me veprimtaritë e tjera të ngjashme të universitetit (shihni pikën 4.11) dhe pronësia intelektuale e të gjithë stafit akademik mbrohet sipas kontratës standarde të punësimit. **[RVV fq. 50; 53, Neni 8, 8.1 dhe 8.2]** KUB-ja përkrah nismat kërkimore të studentëve, duke organizuar konferenca studentore dhe konkurse për temat më të mira, si dhe duke i shpërblyer financiarisht fituesit e këtyre konkurseve. **[RVV fq.50; 105]** KUB-ja i mbështet kërkuesit e rinj përmes Qendrës së për Kërkuesit e Rinj, e cila u ngrit në janar të vitit 2017. **[RVV fq. 50; 70] [Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mekanizmat bazë të vlerësimit nuk janë funksionalë për konferencat shkencore, grantet dhe projektet e kërkimit (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.8**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- përqendrimi menjëherë i KUB-së në marrjen e së masave për përmirësimin e vlerësimit të kërkimit shkencor, duke zbatuar tërësisht udhëzuesin përkatës për përgatitjen e konferencave shkencore dhe Komisionin e Ri të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacion (pika 4.12; **Kapitulli II Standard I.8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 KUB-ja ndjek politikën e duhur për pranimin e studentëve të rinj. Ajo e paraqet ofertën e saj, duke përfshirë edhe kriteret e pranimit për studentët e mundshëm përmes fletëpalosjeve, mbledhjeve, vizitave në shkollat e mesme, panairove, ditëve të hapura dhe faqes së internetit. **[RVV fq. 53; 2, Nenet 69, 76; 3 Nenet 55, 56; 6, Neni 5; 7, Neni15; 63; faqja e internetit (kontrolluar më 25/04/17)]** KUB-ja bashkëpunon ngushtësisht me Drejtoritë Arsimore Rajonale. **[RVV fq.50; Shpjegime 5.1; B20; B21]** Përgjegjëse për mirëpritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj është Zyra e Përzgjedhjes dhe Pranimit. Kjo zyrë garanton përgatitjen e të gjithë dokumentacionit dhe përgatitjen e raporteve vjetore rreth veprimtarisë së saj. **[RVV fq. 50; 3, Neni 4; 5, Neni 32; C4]** Studentët ishin të kënaqur nga përvoja që kishin pasur nga kontakti i parë me universitetin deri në ditët e para të studimeve. **[M5]** Studentët e huaj pranohen në bazë të rezultateve të provimeve të maturës shtetërore ose shkollave të tyre të mesme, dhe këshillohen nga një zyrë e posaçme. **[6, Neni 5; 5, Neni 42; M2; M12]** Raporti i pedagogë-studentë është 1:10. **[RVV fq. 50] [Kapitulli I Standard III.1]**
- 5.2 KUB-ja i informon dhe komunikon me studentët dhe stafin akademik në mënyra të ndryshme. Për çdo student, departamentet caktojnë pedagogë, që luajnë rolin e tutorit. **[RVV fq. 53-54; 3, Neni 61; 6, Neni 6]** Sekretaria Mësimore i afishon njoftimet në këndet e informimit dhe ia dërgon me email të gjithë studentëve. Studentët janë të pajisur me adresë emaili institucionale dhe, në rastet kur organet drejtuese marrin vendime që ndikojnë te studentët, ky vendim skanohet dhe i dërgohet të gjithë studentëve. **[RVV fq. 54; M5; M10]** Me ndihmën e Zyrës së Protokollit dhe Korrespondencës, KUB-ja komunikon së jashtmi me studentët përmes faqes së internetit, mediave sociale dhe Sistemit të Informacionit Beder, **[RVV fq.54; 5, Neni 42; M5; M6]** ndërsa së brendshmi, komunikon nëpërmjet Sekretarisë Mësimore. **[RVV fq.4; M10]** Në rastet kur organet drejtuese marrin vendime që prekin studentët, ky vendim skanohet dhe i dërgohet të gjithë studentëve me email. **[M10; M13]** I gjithë personeli ka adresë emaili të brendshme. Sekretaria Mësimore i ruan dosjet e të gjithë studentëve në përputhje me ligjin. **[50] [Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.3 KUB-ja i orienton dhe i udhëheq studentët në disa mënyra. Krahas pedagogëve të departamenteve të caktuar nga KUB-ja për çdo student dhe këshilltarëve të çdo grupi për secilin vit, **[RVV fq. 54; 3, Neni 61; 6, Neni 6; M12]** institucioni iu ofron studentëve këshillim nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës, e cila drejtohet nga Dekani i Studentëve. Çdo departament cakton një këshilltar për këtë zyrë, i cili i ofron studentëve seminare rreth teknikave të kërkimit të vendeve të punës, hartimit të CV-së, intervistimit dhe mundësive të punësimit. **[RVV fq. 54-55; 3, Nenet 4, 6, dhe 9 (në veçanti për Dekanin e Studentëve); 1, Neni 24; 5, Neni 42]** KUB-ja ofron një Guidë Studenti me 40 faqe, e cila u vlerësua nga studentët si mjaft e dobishme. Guida e Studentit konsiderohet si karakteristikë e praktikës së mirë, pasi iu siguron studentëve informacione të hollësishme dhe lehtësisht të aksesueshme në një material të vetëm rreth programeve të tyre të studimit dhe të gjitha aspekteve të tjera të jetës studentore në universitet. **[50; M5]** Për t'i ofruar studentëve mbështetje në përgatitjen e temës së Masterit, KUB-ja cakton një mbikëqyrës për çdo student, i cili do të takohet personalisht me të të paktën pesë herë, dhe do të paraqesë dy mbrojtje paraprake përpara mbrojtjes përfundimtare. **[M6; M10]** KUB-ja i përgatit programet e studimit në bazë të kriterëve të caktuara në Procesin e Bolonjës, me qëllim që të arrihet përshtatja progresive e studentëve me programet e studimit dhe të ofrohen mundësi për mobilitetet evropian. **[RVV fq. 55; B12]** Institucioni i informon në mënyrë periodike studentët rreth zhvillimeve të rëndësishme institucionale përmes faqes së internetit, materialeve informuese dhe broshurave. **[RVV fq. 55]** Rregulloret për transferimin e studentëve janë të hollësishme, të cilat përfshihen në rregulloren themelore dhe në rregulloret e posaçme individuale me 12 nene. **[3, Nenet 67-72; 15] [Kapitulli I Standard III.3]**
- 5.4 KUB-ja ndjek një politikë mbështetëse për të gjithë studentët pa dallim race, ngjyre, kombësie apo përkatësie fetare, duke përfshirë edhe studentët romë dhe ballkano-egjiptianë. Këtyre grupeve, por edhe grupeve të tjera si p.sh njerëzve në nevojë, jetimëve të prindërve policë dhe të nëpunësve të Ministrisë së Brendshme, iu ofrohen bursa studimi. **[RVV fq. 55; 3, Neni 111; 101; 102, Neni 1; 109]** Studentëve me aftësi të kufizuara në lëvizje iu ofrohen rampa në hyrje dhe një ashensor, të cilat mundësojnë aksesin në të gjithë godinat. Gjithashtu, për studentët

me aftësi të kufizuara ka tualete të posaçme. Studentët e verbër mund të përdorin një sistem elektronik, që mundëson konvertimin e leksioneve në gjuhë Braille. [RVV fq. 5; 3, Nenet 57 dhe 58; M9; M10][*Kapitulli I Standard III.4*]

5.5 KUB-ja i ofron studentëve një literaturë të pasur dhe një mori materialesh elektronike për studimet e tyre. Zyra e menaxhimit të bibliotekës ruan dokumentacionin e burimeve të bibliotekës. Kjo zyrë është përgjegjëse për regjistrimin e titujve të librave të rinj, ndjekjen e blerjeve dhe organizimin e materialeve, siç parashikohet dhe në rregulloren e posaçme. [RVV fq.56; 26] Biblioteka ka rreth 36,000 tituj të formave të ndryshme dhe është e hapur çdo ditë të javës me përjashtim të të dielave. Orari i hapjes afishohet në hyrje të saj. [RVV fq. 56; M5; M9] Për pasurimin e bibliotekës, KUB-ja i ofron departamenteve fonde për blerjen e literaturës së posaçme shkencore të botimeve të fundit në disa fusha të caktuara studimi. [RVV fq. 56; M13] Për ta pasuruar më shumë universitetin dhe bibliotekat e institucioneve të tjera, Departamenti i Shkencave të Komunikimit arriti të mbledhte dhe të dhuronte rreth 10.000 libra falë projektit të studentëve, 'Nëse unë dhuroj, edhe ti mundesh!'. [RVV fq. 56; 58; M9] Biblioteka funksionon nëpërmjet një sistemi të automatizuar, [[http://library.beder.edu.al/](http://library.beder.edu.al) kontrolluar më 25/04/17, në gjendje pune; M9] i cili i ofron materiale në format elektronik, duke mundësuar edhe abonimin në bibliotekën online EbscoHost, ku studentët mund të aksesojnë 45.000 libra dhe 5.000 revista. Gjithashtu, biblioteka mundëson komunikimin me Koleksionin Akademik të Librave. Studentët mund t'i aksesojnë burimet elektronike të bibliotekës edhe kur nuk ndodhen në kampus.[RVV fq.56-57; 30; M9] Ata pajisen me karta studenti dhe janë të kënaqur me burimet e bibliotekës.[3, Neni 63; M5; M6][*Kapitulli I Standard III.5*]

5.6 KUB-ja mbështet studentët e ciklit të parë nëpërmjet shërbimeve, për t'i ndihmuar të përparojnë (shihni pikën 3.8). Syllabusi i çdo kursi publikohet në faqen e internetit të KUB-së dhe gjatë mbledhjes së parë të klasës, pedagogët shpjegojnë në hollësi përmbajtjen e secilit kurs. [RVV fq. 57; 6, Neni 6; Shpjegime 5.7] Studentët, që kanë vështirësi me leksionet, mund t'iu kërkojnë pedagogëve ndihmë individuale. Çdo pedagog i kushton çdo klase disa orë të caktuara.. [RVV fq. 57; M5; M10] Së fundmi, KUB-ja ka filluar të ofrojë kurse intensive të gjuhës angleze për studentët nëpërmjet Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Gjatë vitit akademik 2016-2017, ishin regjistruar 176 studentë në pesë klase të gjuhës angleze. [RVV fq.57; Shpjegime 5.8; http://law.beder.edu.al/sh/content/default/-bachelor-ne-drejttesi-11-4/372/373/?_con=0&cid=2763&t=1&oid=2433; kontrolluar më 28/05/17, në gjendje pune] Shihni edhe pikën 5.3. [*Kapitulli I Standardi III.6*]

5.7 KUB-ja nxit pjesëmarrjen e studentëve në jetën universitare. Ajo e përkrah Këshillin Studentor, dhe ka caktuar një sallë të posaçme për mbledhjet e tij, dhe një zyrë me madhësi mesatare për tetë klubet studentore. [RVV fq. 57; 2, Neni 99; 5, Neni 42; 82; Shpjegime 5.4; M9] Këshilli Studentor i shpreh mendimet dhe i paraqet propozimet e tij rreth temave me interes të përgjithshëm, si p.sh rreth planeve mësimore, rregulloreve dhe programeve të studimit, nëpërmjet përfaqësuesve, që janë pjesë e organeve kolegjiale të universitetit dhe luajtën një rol mjaft të rëndësishëm gjatë përgatitjes së Raportit të Vetëvlerësimit. [RVV fq. 57; Shpjegime 5.4; M2] Senati Akademik ka në përbërjen e tij edhe një përfaqësues të studentëve. [2, Neni 10, 1.e; 3, Neni 11; 4, Neni 5, a] Zëri i studentëve në Senat Akademik nuk dëgjohet aq sa do të dëshironte Rektori dhe për ta ndryshuar këtë situatë, Rektori organizon mbledhje me studentët. Pavarësisht kësaj, ndër problemet që kanë paraqitur studentët dhe që janë zgjidhur nga Senati Akademik ka qenë nevoja për të pasur një palestër, dhe shqetësimet e tyre lidhur me nivelin relativisht të lartë të notave mesatare, që duheshin për të kaluar nga viti i parë në vitin e tretë të ciklit të parë të studimeve. [M1; M3; M4] Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka në përbërjen e saj edhe një përfaqësues të studentëve.[2, Neni 28] Në çdo Këshill Departamenti marrin pjesë dy studentë: njëri nga cikli i parë, dhe tjetri nga cikli i dytë., [39] ndërsa në Këshillin e çdo Fakulteti ftohen të marrin pjesë tre studentë. [39] Ndër problemet që studentët kanë ngritur pranë departamenteve dhe fakulteteve, për të cilat janë marrë masa, mund të përmenden shkalla e kalueshmërisë, blerja e librave të rinj dhe mbështetja financiare për studentët e kategorive të veçanta. [M1; M6] [*Kapitulli I Standard III.7*]

5.8 KUB-ja ndjek një politikë për garantimin e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtari sportive dhe kulturore në përmasa sado të vogla. Duke u mbështetur në buxhetin e Dekanit të

Studentëve, universiteti përkrah Këshillat Studentorë dhe klubet e studentëve, ku këto të fundit synojnë zhvillimin e aftësive sociale, kulturore, intelektuale dhe sportive të studentëve. **[RVV fq. 57-58; 27; 82]** KUB-ja ofron mbështetje për aktivitetet sportive, si p.sh. dy uniforma të personalizuar futbolli dhe transport për kampionatet ndëruniversitare, siç është ai i “Universiadës së Tiranës”. Për më tepër, studentët kanë në dispozicion edhe një palestër të vogël, si dhe kanë klubet e tyre sportive. **[RVV fq. 55; 82; Shpjegime 5.3; M9]** Studentët përmendën disa aktivitete kulturore, si panairi ndërkombëtar, dhe disa aktivitete të tjera sportive, duke përfshirë futboll, basketboll, tenis tavoline dhe palestër. **[M5; M6; Anketimi i Studentëve, 15.ix dhe 15.x]** KUB-ja ka punësuar kompani për garantimin e sigurisë fizike, përfaqësuesit e së cilës janë të pranishëm 24 orë në ditë, dhe një mjek, i cili qëndron për katër orë në ditë në një ambient të posaçëm në universitet. **[RVV fq. 58; 98; B22; Shpjegime 5.9; M9]** Institucioni ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Amerikan, në bazë të së cilës studentët dhe stafi përfitojnë ulje tarifash për shërbimet mjekësore. **[RVV fq. 58; 99]** KUB-ja ka edhe një Zyrë për Kujdesin Psikologjik dhe Shëndetësor. **[5, Neni 42] [Kapitulli I Standard III.8]**

5.9 KUB-ja i ndihmon studentët të gjejnë punë. Ajo ka një Zyrë për Alumni dhe një Zyrë për Planifikimin e Karrierës, e cila mbikëqyret nga Dekani i Studentëve. **[RVV fq. 58; 5, Neni 42; M2; M13]** Procedurat që ajo ndjek janë të qarta dhe mbështeten nga i gjithë stafi akademik dhe personeli administrativ për integrimin e studentëve në punësim me anë të praktikave profesionale të organizuara gjatë gjithë vitit dhe marrëveshjeve të nënshkruara me kompani të ndryshme. Aktualisht, nga 497 të diplomuar në të dy ciklet e studimit, 87% e tyre janë të punësuar ose vazhdojnë studimet e specializuara. **[M3; M4; M13]** Ndonëse nuk është kriter, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në praktika profesionale dhe stazhe. **[RVV fq. 58; 88; 92; Shpjegime 5.8; M3; M4]** Shumë studentë përmendën shembuj të rasteve ku kanë punuar brenda dhe jashtë vendit, gjë që i ka ndihmuar të përgatiten më mirë për tregun e punës, dhe shumë prej punëdhënësve pohuan se parapëlqenin t punësonin me kohë të plotë studentë që e kishin kryer praktikën profesionale pranë tyre. **[M5; M6; M7]** KUB-ja i ruan statistikat e punësimit të të diplomuarve në Sistemin e Informacionit Beder. **[RVV fq. 58; 2, Neni 100-101; 84; 85; C7; M3; M4]** Institucioni ofron mbështetje për të diplomuarit e tij, gjë që vërtetohet nga fakti se 15 prej tyre janë punësuar në universitetet. **[RVV, fq. 58] [Kapitulli I Standard III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Guida e studentëve të KUB-së, iu siguron studentëve informacione të hollësishme dhe lehtësisht të arritshme në një material të vetëm rreth programeve të tyre të studimit dhe të gjitha aspektet e tjera të jetës studentore në universitet (pika 5.3; **Kapitulli I Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

GID-Të dhëna të përgjithshme

RVV- Raporti i Vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit institucional

1 Statuti i IAL-së Hëna e Plotë (Beder)

2 Statuti i Kolegjit Universitar Beder

3 Rregullorja themelore

4 Rregullore e organizimit akademik

5 Rregullore e organizimit administrativ

6 Rregullore e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

7 Rregullore e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

8 Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Këshillit të Sigurimit të Cilësisë

9 Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

10 Rregullore për vlerësimet dhe anketimet

11 Rregullore për projektet e kërkimit

12 Rregullore për arkivin

13 Rregullore për punësimin, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e performancës së personelit

14 Rregullore për zyrën e regjistrimit

15 Rregullore për transferimin e studimeve

16 Rregullore për transferimin e studimeve; Rregullore për Qendrën Kërkimore dhe Zhvillimore për Shkencat Islame

17 Rregullore për Qendrën Kërkimore dhe Zhvillimore për Studimin e Medias dhe Komunikimin

18 Rregullore për uljen e tarifës së shkollës

19 Rregullore e programit (Rregullore për Master i Shkencave në Profilin e Drejtësisë, së Drejtës Penale dhe së Drejtës Ndërkombëtare)

20 Rregullore për disiplinën e studentëve

21 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe të Programeve

22 Statuti i Qendrës së Kërkuesve të Rinj

23 Udhëzim për nxitjen e botimeve dhe kërkimit

24 Udhëzim për procesin e zhvillimit të kurrikulës

25 Udhëzim për ngarkesën mësimore

26 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës

27 Udhëzim për klubet studentore

28 Procedura e përditësuar për punësimin e personelit

29 Procedura e punësimit të personelit

30 Informacion i hollësishëm mbi bibliotekën

31 Procedurat e operimit të Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulës

32 Skema organizative

33 Plani strategjik 2012-2017

34 Vendim i Senatit për miratimin e planit strategjik 2012-2017

35 Vendim i Senatit për ndryshimin e planit strategjik

36 Vendimi i Senatit për ndryshimin e rregullores "Për studimet e ciklit të parë dhe provimeve"

37 Vendime të Senatit për emërimet e ekspertit të jashtëm në Këshillin e Sigurimit të Cilësisë

- 38 Vendim i Këshillit të Ministrave për Licensimin e Shkollës së Lartë Hëna e Plotë (Bedër)
- 39 Vendimi i Senatit për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale.pdf
- 40 Vendimi i Senatit për ngritjen e këshillit të sigurisë dhe shëndetit në punë
- 41 Vendimi i Senatit për ngritjen e qendrës së kërkuesve të rinj
- 42 Ftesë nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për aplikim dhe fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional me Agjencinë Britanike të Sigurimit
- 43 Urdhër nr. 223, datë 04.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit
- 44 Urdhri i Ministres nr. 616, datë 12.30.2016 “Për miratimin e statutit të KUB-së”
- 45 Urdhër mbi ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)
- 46 Urdhër mbi ngritjen e komisionit për hartimin e planit të ri strategjik 2017-2022
- 47 Vendim i Senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme
- 48 Certifikata ISO 9001 2008
- 49 Guida e stafit
- 50 Guida e studentëve
- 51 Rregullat për organizimin e provimeve
- 52 Formular për vlerësimin e performancës së stafit akademik
- 53 Formular për kontratën e punësimit të personelit
- 54 Shembull i librit të punimeve që përgatiten për konferenca, të cilat vërtetojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve
- 55 Shembull i emërimeve të bëra nga një departament për këshilltarët akademik
- 56 Raporti i vlerësimit të jashtëm që kërkohet nga IAL-ja
- 57 Raporti Vjetor Institucional
- 58 Raport për veprimtaritë
- 59 Dokumentacioni i një mbledhjeje
- 60 Shembull “miratimi i buxhetit”
- 61 Zbatimi praktik i procedurës së rekrutimit
- 62 Statistika për ngritjen në detyrë të stafit akademik ndër vite
- 63 Praktika e ndjekur për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve
- 64 Praktikë e auditimit të brendshëm
- 65 Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca
- 66 Rastet praktike të shkëmbimit të studentëve dhe stafit
- 67 Vlerësim i stazhit mësimdhënës
- 68 Manual i Sigurimit të Cilësisë
- 69 Shembull teze provimi
- 70 Vendime për organizimin e programeve Start Up dhe Mentorship
- 71 Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore në rektorat
- 72 Shembull i raportit vjetor të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze
- 73 Shembull i diplomës dhe suplementit të diplomës
- 74 Anketimet e vlerësimit të studentëve për kursin dhe pedagogun
- 75 Konferencat studentore
- 76 Programi Fulbright, dokumentacioni për Mevlana
- 77 Caktimi dhe ngarkesa mësimore e kursit (përditësim)
- 78 Programet e shkëmbimit të stafit dhe studentëve
- 79 Plani i veprimit për formimin e stafit
- 80 Përshkrimi i punës
- 81 Anketime për kënaqshmërinë e studentëve (përditësim)
- 82 Veprimtaritë e klubit studentor
- 83 Lista e stafit akademik për departament dhe, diplomat dhe titujt përkatës

- 84 Statistika për diplomimin dhe punësimin e studentëve
- 85 Statistika për të diplomuarit
- 86 Lista e stafit akademik të arsimuar jashtë vendit.pdf
- 87 Lista e programeve dhe një shembull programi
- 88 Lista e stazheve studentore
- 89 Lista e infrastrukturës teknologjike
- 90 Konferencat Shkencore
- 91 Projektet me institucionet e tjera
- 92 Lista e institucioneve partnere
- 93 Leja higjieno-sanitare
- 94 Leja teknike për mbrojtjen kundër zjarrit
- 95 Certifikatë pronësie dhe plani i kampusit
- 96 Planimetria e godinës aktuale
- 97 Kontrata me kompaninë e sigurisë ALSIG
- 98 Kontrata me Albpastrim
- 99 Marrëveshja me spitalin amerikan
- 100 Kontrata me British Council
- 101 Marrëveshja me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- 102 Marrëveshja me Ministrinë e Brendshme
- 103 Kontrata e qirasë me USLUGA
- 104 Projektet për të cilat ka aplikuar
- 105 Konkurs për tezën më të mirë të përgatitur nga studentët
- 106 Veprimtaria e IAL-së mbi dialogun ndërfaqor
- 107 Strukturat e KUB-së (përditësim)
- 108 Udhëzim për Sistemin e Informacionit të Beder-it (SIB)
- 109 Statistika rreth bursave në formën e zbritjeve të tarifave të studimit ndër vite

LISTA E DOKUMENTEVE MBËSHTETËSE TË IAL-së

Dokumenti nr. 34 Vendim i senatit për miratimin e planit strategjik 2012-2017 (i përditësuar)

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT NË KUADËR TË AKREDITIMIT

B. Lista e dokumenteve shtesë (faza e vlerësimit e bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit)

DOKUMENTE SHITESË DHE PYETJE SHPJEGUESE.pdf-Shpjegimet

- B1 Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimeve.pdf
- B2 Mbledhja e NjSBC-së 2017-002 më 25.03.2017.pdf
- B3 Mbledhja e KSC-së 2014-013 më 18.10.2014.pdf
- B4 Raporti Vjetor në anglisht 2015-2016.pdf
- B5 Vendim i Këshillit të Fakultetit dërguar Senatit.pdf
- B6 Vendim departamenti për buxhetin dhe vendimi vijues i fakultetit.pdf
- B7 Seminaret dhe workshop-et.pdf
- B8 MM me Turgut Ozal Education Sh.a.pdf
- B9 Aplikim për projekt me Universitetin e Burch-it.pdf
- B10 Aplikim për projekt me Terre des Hommes.pdf
- B11 Vendim Senati.pdf
- B12 Syllabusi i Krahasimit të Sistemeve Ligjore.pdf
- B13 Mbledhje e KSC-së 2014-004 më 08.09.2014.pdf

B14 "Procedurat për zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve të kërkimit".pdf
B15 Dokumente për aplikimin dhe miratimin e projekteve dhe raporteve të dorëzuara
B16 Grupet kërkimore.pdf
B17 Formular aplikimi.pdf
B18 Raporti i stazhit të studentëve.pdf
B19 Vërtetim për kryerjen e stazhit.pdf
B20 Workshop.pdf
B21 Korrespondenca me DAR-in e Tiranës.pdf
B Dokumente shtesë nr. 22 Kontrata e KUB-së me doktorët e punësuar.pdf
LISTA E DOKUMENTEVE SHITESË.pdf

C. Lista e dokumenteve shtesë gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm

C.1 Të dhëna rreth studentëve të diplomuar në Bachelor dhe Master pranë KUB-së.pdf
C.2 Prioritetet dhe politikat e bashkëpunimit ndërkombëtar _ Mobiliteti i studentëve dhe stafit.pdf
C.3 Nota mesatare e studentëve të rinj të regjistruar në Master 2016.pdf
C.4 Dita e orientimit 2016.pdf
C.5 Nota mesatare e studentëve të rinj të regjistruar në Bachelor 2016.pdf
C.6 LISTA E PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA JASHTË.pdf
C.7 Formular informacioni për studentët e diplomuar.pdf

Mbledhjet

M1- Mbledhja 1 Rektori
M2- Mbledhja 2 Grupi i Vetëvlerësimit
M3 & M4- Mbledhjet 3 dhe 4 Senati & Rektorati
M5- Mbledhja 5 Studentët, cikli i parë
M6- Mbledhja 6 Studentët, cikli i dytë
M7- Mbledhja 7 Alumni dhe partnerët
M9- Mbledhja 9 Turi i universitetit
M10- Mbledhja 10 Drejtuesit dhe sekretaret
M11- Mbledhja 11 Profesorët dhe kërkimi
M12 - Mbledhja 12 Stafi akademik
M13- Mbledhja 13 Administratori